

The image shows the interior of a traditional building, likely a rural structure in Kosovo. The ceiling is a complex network of dark, weathered wooden beams, some of which are curved. The walls are made of rough-hewn stone and plaster, showing signs of age and wear. The lighting is dramatic, with strong shadows and highlights, creating a sense of depth and texture. The overall atmosphere is one of historical authenticity and rustic charm.

Perspektiva e Qytetarëve për një Strategji të Ardhshme për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë

**Perspektiva e Qytetarëve për një
Strategji të Ardhshme për
Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë**

Gëzim Visoka dhe Besart Lumi

Kolofon

Botim nga New Social Initiative, Integra dhe PAX

Dhjetor 2020

Autorë: Dr. Gëzim Visoka & Besart Lumi

Foto e kopertinës: Korab Krasniqi

Dizajni dhe Ndarja: Milan Dobrić

Përkthyer në shqip nga: Armend Bërlajolli

FALENDERIME

Autorët dëshirojnë të shprehin mirënjohje për ndihmën profesionale dhe reagimet e konsiderueshme të ofruara nga Kathelijne Schenkel, Kushtrim Koliqi dhe Jovana Radosavljeviç. Dëshirojmë gjithashtu të falënderojmë të gjithë individët që ndanë njohuri dhe mendime në intervista ose seanca të fokus grupeve. Raporti gjithashtu përfitoi shumë nga të gjitha sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Grupit Bazë të Shoqërisë Civile, përkatësisht: Nora Ahmetaj, Igballe Rogova (Rrjeti i Grave të Kosovës), Shukrije Gashi (Partnerët Kosova), Dejan Radivojeviç (FDMC), Mehmet Musaj (KRCT), Lazar Rakiç (ADRC), Marigona Shabiu (YIHR Kosova), Nemanja Nestoroviç (CBM) dhe Sara Salihu (MPRC). Së fundmi, jemi shumë mirënjohës për mbështetjen financiare të dhënë nga Ambasada Amerikane në Kosovë dhe PAX.

PËR AUTORËT

Dr. Gëzim Visoka është Profesor i Asocuar i Paqes dhe Studimeve të Konfliktive në Universitetin e Qytetit të Dublinit në Irlandë. Ai ka botuar gjerësisht për Kosovën, drejtësinë tranzicionale dhe ndërtimin e paqes pas konfliktit.

Z. Besart Lumi është aktivist për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Ai mban një master në Zgjidhjen e Konfliktive nga Universiteti i Denverit, SHBA.

NEW SOCIAL INITIATIVE

NSI është një organizatë e shoqërisë civile që fuqizon komunitetet jo-shumicë për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës dhe rrit besimin mes komuniteteve duke mbështetur trajtimin e së kaluarës dhe normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. www.newsocialinitiative.org

INTEGRA

Misioni i Integra është të ndihmojë zhvillimin e Kosovës, veçanërisht në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe integritimit duke trajtuar dhe promovuar rrëfime dhe përvoja të komuniteteve të marginalizuara, duke kontribuar kështu në proceset e demokracisë, ndërtimin e besimit dhe bashkëjetesës. www.ngo-integra.org

PAX

PAX punon me qytetarë dhe partnerë të përkushtuar për të mbrojtur civilët kundër akteve të luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur dhe për të ndërtuar paqen e drejtë. PAX operon në mënyrë të pavarur nga interesat politike. www.paxforpeace.nl

Mbështetur nga:



Ky projekt u financua përmes një granti të Ambasadës Amerikane, Prishtinë. Opinionet, gjetjet dhe konkluzionet ose rekomandimet e shprehura këtu janë të autorit/autoreve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



Përmbajtja

1. Hyrje dhe gjetjet kryesore	7
2. Argumenti për një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale ...	10
3. Qëllimi dhe parimet e një strategjie të ardhshme për drejtësinë tranzicionale	13
4. Shtyllat kryesore të një strategjie të ardhshme për drejtësinë tranzicionale	16
5. Përfundimet dhe rekomandimet	26
6. Anekset	29

1. Hyrje dhe gjetjet kryesore

Derisa shoqëria kosovare vazhdon të vuajë nga trashëgimia e konfliktit të dhunshëm të pazgjidhur të viteve 1998-99, deri më tani akterët ndërkombëtarë dhe kombëtarë nuk kanë arritur të hartojnë një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale që do të trajtonte mirëfilli dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet e diskutueshme dhe përçarëse nga e kaluara. Në vend të kësaj, përpjekjet për trajtimin e të kaluarës kanë ndodhur përmes iniciativave krah për krah të cilave shpesh u ka munguar koordinimi e angazhimi i qëndrueshëm dhe të cilat kanë lënë anash çështje të rëndësishme e imediate për viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit (komunitetet e prekura). Siç është përshkruar në një studim të veçantë, iniciativat e kaluara karakterizohen nga një interesim i pamjaftueshëm nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për të përfshirë çështjet e drejtësisë tranzicionale në paqe-bërjen dhe bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës.¹ Po kështu, përpjekjet e kaluara të institucioneve të Kosovës karakterizohen nga agjenda jo të plotë, të politizuara dhe të personalizuara të liderëve politikë kombëtarë të cilët kanë trajtuar vetëm në mënyrë selektive dhe sporadike disa çështje të drejtësisë tranzicionale. Në një shkallë të caktuar, iniciativat e shoqërisë civile dhe organizatat që përfaqësojnë komunitetet e prekura kanë qenë aktorët më aktivë në promovimin e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimit të së kaluarës në Kosovë, pavarësisht se përballen me shumë kufizime dhe sfida.

Masat e drejtësisë tranzicionale kritikohen gjithnjë e më shumë si të kuptuara dhe të zbatuara si një model ose si pjesë e një pakete mjetesh, përkatësisht një grup i ngushtë masash që do të zbatohen në mënyrë uniforme kudo që kanë ndodhur shkelje të përhapura të të drejtave të njeriut, pa marrë parasysh shumë nevojat e ndryshme dhe perspektivat e bashkësive të prekura. Në veçanti, strategjitë kombëtare tentojnë të gjenerohen përmes proceseve nga lart-poshtë dhe të jenë të përqendruara në ekspertë, shpesh duke hequr përfshirjen e drejtpërdrejtë të komuniteteve të prekura. Ky studim synon t'u sjellë qytetarëve të Kosovës një perspektivë mbi drejtësinë tranzicionale dhe trajtimin e së kaluarës, e cila shpresojmë se do të merret parasysh kur të hartohet një strategji e ardhshme kombëtare për drejtësinë tranzicionale. Ndërsa studimi nuk ofron një model se si duhet të duket strategjia e ardhshme për drejtësinë tranzicionale, ofron një përmbledhje të qëllimeve, përparësive dhe çështjeve më të spikatura që qytetarët në Kosovë i konsiderojnë si thelbësore për t'u adresuar dhe përfshirë në të ardhmen. Studimi duhet të lexohet si një shtesë e studimit të botuar më parë të titulluar "Demokratizimi i Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë", i cili ofron një rishikim të hollësishëm të drejtësisë tranzicionale në të kaluarën dhe propozon një qasje me katër hapa për zhvillimin e një infrastrukture institucionale për t'u marrë me të kaluarën në Kosovë.²

Në kuptimin e nevojave të qytetarëve, si dhe të pritjeve nga një strategji e ardhshme, u organizuan dhjetë diskutime në fokus grupe si dhe intervista me qytetarët midis gushtit dhe nëntorit 2020 me 156 pjesëmarrës nga të gjitha bashkësitë etnike në Kosovë. Pjesëmarrësit u zgjodhën nga prejardhje të ndryshme, nga të gjitha rajonet e Kosovës dhe përfaqësonin të gjitha grupet etnike. Disa fokus grupe u organizuan me grupe specifike si gratë, të rinjtë dhe anëtarët e familjeve të personave të zhdukur. Pavarësisht nga kjo qasje e gjerë e përfshirjes, studimi nuk pretendon të japë një pasqyrë të plotë të perspektivave dhe nevojave të të gjithë qytetarëve të Kosovës, por jep një pasqyrë për çështjet kryesore urgjente dhe

¹ Gëzim Visoka dhe Besart Lumi, *Demokratizimi i Drejtësisë Tranzicionale: Drejt një Infrastrukture diskutuese për Trajtimin e së Kaluarës*, Integra, NSI, PAX, 2020, Prishtinë, Kosovë. Në dispozicion në: <https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/democratizing-transitional-justice-in-kosovo>. ² Po aty.

nevojat e qytetarëve të Kosovës. Pjesëmarrësve iu dha mundësia të ofronin kontributet e tyre mbi qëllimin, parimet kryesore dhe elementet që do të duhej të merrte parasysh një strategji përfundimtare për drejtësinë tranzicionale. Për më tepër, në nëntor 2020 u mbajt një takim konsultativ me organizatat kryesore të shoqërisë civile që punojnë në drejtësinë tranzicionale në Kosovë për të diskutuar gjetjet paraprake dhe përfshirë perspektivën e tyre gjithashtu.³

Në përgjithësi, ky studim zbulon se qytetarët besojnë se ka kohë që Kosova ka një qasje kombëtare dhe gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale dhe trajtimin e së kaluarës. Shumica e pjesëmarrësve përshkruan nevojën për një strategji gjithëpërfshirëse e cila merr parasysh shqetësimet dhe nevojat e të gjithë individëve dhe grupeve të prekur nga konflikti i dhunshëm, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike ose shoqërore. Përderisa nevoja për një strategji gjithëpërfshirëse për trajtimin e së kaluarës dhe drejtësinë tranzicionale është ngritur qartë në mesin e të gjithë pjesëmarrësve në diskutimet e grupeve të fokusit, ekziston një skepticizëm i vazhdueshëm midis tyre mbi gjasat për zbatim të suksesshëm në praktikë. Ekziston dyshimi se ngjashëm me strategjitë dhe politikat e tjera në Kosovë dhe për shkak të kapaciteteve dhe burimeve të kufizuara institucionale, përpjekjet e ardhshme mund të mos arrijnë qëllimet e tyre të dëshiruara, duke humbur kështu një mundësi tjetër për të adresuar trashëgiminë e së kaluarës përmes masave strategjike dhe gjithëpërfshirëse.

Përtej gatishmërisë institucionale dhe kapacitetit për të hartuar dhe zbatuar një strategji të tillë, gjetjet e këtij studimi tregojnë se kuptimi i drejtësisë tranzicionale në Kosovë është i ndërthurur thellë me identitetin etnik, i cili ka implikime serioze në hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për trajtimin e së kaluarës në vend. Trajtimi i së kaluarës në Kosovë është jashtëzakonisht problematik pasi nuk ka konsensus dhe pak ndjeshmëri mes grupeve etnike mbi atë se si të trajtohen trashëgimia e të kaluarës, si të merren me të dhe të pranojnë histori, përvoja dhe perspektiva të komuniteteve të tjera etnike, si dhe se si të vazhdohet kah, dhe të parashikohet, një e ardhme e përbashkët. Ekziston një predispozitë për ta reduktuar drejtësinë tranzicionale në një drejtësi vetëm mono-etnike dhe një-dimensionale. Për shqiptarët e Kosovës, trajtimi i së kaluarës përfshin zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, të tilla si personat e zhdukur, ndjekjen penale të autorëve të krimeve të luftës, pretendimin e dëmshpërblimeve dhe kompensimin e dëmeve të luftës, si dhe forcimin e shtetësisë së pavarur duke bindur Serbinë të njohë pavarësinë e Kosovës dhe komunitetin lokal serb të pranojë shtetësinë e Kosovës. Sidomos, mes shqiptarëve të Kosovës, paqja me Serbinë do të jetë e pamundur derisa të zgjidhen të gjitha çështjet e pazgjidhura nga e kaluara, domethënë derisa të shfaqet e vërteta, drejtësia dhe dëmshpërblimet për krimet e luftës që do të kënaqnin komunitetet e prekura.⁴

Nga ana tjetër, për serbët e Kosovës trajtimi i së kaluarës shihet si problematik pasi që nuk ka gjasa të sjellë drejtësi për viktimat e tyre dhe të kontribuojë pozitivisht në marrëdhëniet e tanishme dhe të ardhshme etnike në Kosovë dhe rajonin e gjerë. Për ta, trajtimi i së kaluarës përfshin problematizimin e rezistencës së armatosur të shqiptarëve dhe justifikimin e veprimeve të Serbisë për të mbrojtur rendin e vendosur nga regjimi i Millosheviçit.⁵ Në vend të kësaj, ekziston një tendencë mes serbëve të Kosovës për ta lëvizë diskutimin vetëm në trajtimin e çështjeve post-konfliktuale dhe atyre të tanishme. Gjegjësisht, që të përqendrohet vëmendja në periudhën pas konfliktit dhe në trajtimin e padrejtësive të perceptuara dhe hapësirën e kufizuar për komunitetin serb në Kosovë për të ushtruar të drejtat e tyre politike, socio-ekonomike dhe gjuhësore, përfshirë të drejtën për

³ Grupi Bazë i Shoqërisë Civile përbëhet nga: Nora Ahmetaj, Igballe Rogova (Rrjeti Kosovës grave), Shukrije Gashi (Partners Kosova), Dejan Radivojeviç (FDMC Graçanicë), Mehmet Musaj (QKRM), Lazar Rakiç (ADRC), Marigona Shabiu (YIHR Kosovë), Nemanja Nestorović (CBM) dhe Sara Salihu (MPRC).

⁴ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë ⁵ Fokus Grupi 9, 20 gusht 2020, rajoni i Mitrovicës, Kosovë..

lëvizje të lirë dhe kthimin në vendbanimet e para luftës. Për komunitetet e tjera më të vogla etnike, drejtësia tranzicionale mbetet e mangët pasi ekziston një ndjenjë që komunitetet e tyre nuk kanë marrë vëmendjen dhe mbështetjen e merituar në kërkimin e së vërtetës dhe drejtësisë për krimet e luftës në të kaluarën dhe as nuk kanë përfituar nga skema të ndryshme socio-ekonomike të pasluftës si kanë bërë komunitetet tjera mbizotëruese.

Me qenë se drejtësia tranzicionale dhe trajtimi i së kaluarës kanë një kuptim të ndryshëm për bashkësitë e ndryshme etnike në Kosovë, strategjia e ardhshme duhet ta marrë parasysh këtë dhe të sigurojë që ajo të jetë hartuar nga poshtë-lart dhe të sigurojë që të përfshijë të gjitha komunitetet e prekura. Ky është një parakusht për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse mosmarrëveshjet e pazgjidhura dhe për të kapërcyer trashëgiminë e mbetur të konfliktit të dhunshëm. Me pak fjalë, besueshmëria e çdo strategjie të ardhshme do të qëndrojë në aftësinë e saj për të siguruar një qasje të paanshme, parimore, të bazuar në të drejta dhe të përqëndruar tek njerëzit, për të hartuar, zbatuar dhe vlerësuar veprime të ardhshme në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimin e së kaluarës.⁶ Ky studim është strukturuar si vijon. Së pari, ofrohet një përmbledhje e shkurtër e situatës ekzistuese për të përcaktuar shkallën e problemit dhe nevojën e ngutshme për një strategji për drejtësinë tranzicionale. Së dyti, ofrohet perspektiva e qytetarëve për qëllimin dhe parimet që udhëheqin strategjinë e ardhshme për të nxjerrë në pah nevojat dhe pritjet e tyre të përcaktuara gjerësisht. Së treti, studimi ofron një përmbledhje të çështjeve kryesore që qytetarët do të dëshironin të shfaqeshin në një strategji të ardhshme për drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Së fundmi, studimi ofron një numër rekomandimesh dhe vëzhgimesh të gjera që mund të jenë të dobishme për ata që janë përgjegjës për hartimin e strategjisë së ardhshme në Kosovë.

⁶ Ndërsa trajtimi i së kaluarës është një koncept i cili mbulon një gamë të gjerë çështjesh dhe trashëgimisë që dalin nga konflikti, drejtësia tranzicionale përfshin një grup masash dhe veprimesh shumë më të ngushta për të sjellë drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit. Në këtë raport, ne do të përdorim nyjen dhe nganjëherë veçmas, siç kërkohet në mënyrë të përshtatshme.

2. Argumenti për një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale

Çështjet e pazgjidhura dhe trashëgimia e konfliktit të dhunshëm 1998–99 në Kosovë vazhdojnë të dominojnë diskursin politik në Kosovë dhe Serbi në vetvete. Këto çështje të pazgjidhura vazhdojnë të pengojnë mundësinë e qytetarëve të Kosovës për t'u pajtuar me të kaluarën dhe për të shkuar drejt së ardhmes. Qytetarët kanë ngulitur një perceptim negativ në lidhje me gatishmërinë dhe kapacitetin e bashkësisë ndërkombëtare, autoriteteve serbe dhe qeverisë së Kosovës për të promovuar drejtësinë dhe luftuar mos-ndëshkueshmërinë për krimet e luftës në të kaluarën dhe abuzimet serioze të të drejtave të njeriut. Më e rëndësishmja, trashëgimia e vonuar e konfliktit të fundit në Kosovë vazhdon të shërbejë si një faktor nxitës dhe burim grindjesh mes dhe përmes grupeve etnike në Kosovë, dhe shpesh përdoret për agjenda politike dhe elektorale. Kjo pjesë ofron një përmbledhje të shkurtër të shkallës së problemit me drejtësinë tranzicionale në Kosovë dhe përshkruan perceptimin e qytetarëve për nevojën e ngutshme për një angazhim gjithëpërfshirës me këtë çështje.

Në dy dekadat e fundit, përpjekjet për t'u marrë me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale kanë ndodhur pa një strategji gjithëpërfshirëse. Kryesisht kemi qenë dëshmitarë të iniciativave specifike sektoriale dhe krah për krah dhe rrugëve institucionale dhe ligjore për të adresuar veçmas çështje të ndryshme në lidhje me konfliktin (shih Shtojcën 6.1). Fillimisht, mundësia për të hartuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për drejtësinë tranzicionale u humb gjatë administratës së përkohshme të KB në Kosovë (1999–2008). Gjatë kësaj periudhe, përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare u përqendruan në adresimin e çështjeve të tjera të ngutshme në Kosovë, të tilla si: ndihma humanitare, siguria dhe qeverisja. Sidoqoftë, statusi i pazgjidhur politik i Kosovës dhe përparësia e agjendës së stabilizimit afatshkurtër dhe ndërtimit të shtetit kanë luajtur një rol të madh në anashkalimin e nevojës së ngutshme për t'u marrë me të kaluarën. Më e rëndësishmja, mungesa e një marrëveshje paqeje midis Serbisë dhe Kosovës ka vendosur një trajektore negative e cila ka ndikuar dukshëm në politikën e drejtësisë tranzicionale në Kosovë dhe në rajonin e gjerë. Që nga ajo kohë, çështjet e krimeve të luftës janë trajtuar kryesisht nga gjykatat ndërkombëtare dhe hibride, ndërsa fati i personave të zhdukur dhe iniciativat e kërkimit të së vërtetës u delegohen agjencive të specializuara dhe grupeve të shoqërisë civile. Deri më tani, shumica e vëmendjes i është kushtuar gjykimeve të krimeve të luftës të drejtuara nga gjykatat ndër kombëtare, hibride dhe kombëtare në Kosovë. Drejtësia për krimet e luftës dhe abuzimet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut kërkohet përmes mekanizmave gjyqësorë të veçantë dhe nën autoritete të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare. Sidoqoftë, historiku i hetimeve dhe aktakuzave për krimet e luftës të ndërmarra nga gjykatat ndërkombëtare dhe ato vendore mbetet i pakënaqshëm. Midis vitit 1999 dhe 2020, vetëm 117 individë u paditën për krime lufte dhe abuzime serioze të të drejtave të njeriut në Kosovë, nga të cilët 62 kanë qenë shqiptarë, 49 serbë, 5 malazezë dhe një nga komuniteti rom.⁷ Gjykata e Specializuar e Kosovës, e cila bëri padinë e tyre të parë publike në shtator 2020, mbetet e kontestuar gjerësisht prej institucioneve politike të Kosovës dhe komunitetit shumicë shqiptar.⁸

⁷ Sabina Pergega, Mirvet Thaqi dhe Medina Kadriu, 'Amnistia e Krimeve të Luftës në Kosovë', Instituti Ligjor i Kosovës, Prishtinë, Kosovë 2020. Në dispozicion në: <https://kli-ks.org/amnistia-e-krimeve-te-luftes-ne-kosove/>

⁸ KSK u krijua sipas ligjit të Kosovës në 2015 me "një mandat dhe juridiksion specifik mbi krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krime të tjera sipas ligjit të Kosovës, të cilat ishin filluar ose kryer në Kosovë ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 nga ose kundër qytetarëve të Kosovës ose Republikës Federale të Jugosllavisë". Shikoni gjithashtu: Gëzim Visoka, 'Vlerësimi i Ndikimit të Mundshëm të Gjykatës Speciale', Visoka, Vlerësimi i Ndikimit të Mundshëm të Gjykatës Speciale të Kosovës, Utrecht dhe Hagë, NL: PAX and Impunity Watch, 2017. Në dispozicion në: <https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/assing-the-potential-impact-of-the-kosovo-specialist-Court>.

Fokusi mbizotërues në gjykimet e krimeve të luftës ka ndikuar në aspekte të tjera të rëndësishme të trajtimit të së kaluarës, të tilla si: kërkimi dhe dokumentimi i së vërtetës, përkujtimi, dëmshpërblimet dhe kompensimi si dhe njohja dhe mbështetja për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit pavarësisht nga identiteti dhe statusi i tyre. Përpjekjet për identifikimin e trupave të personave të zhdukur janë trajtuar nga agjenci të shumta ndërkombëtare dhe lokale. Qeveria e Kosovës ka krijuar infrastrukturën ligjore dhe institucionale për personat e zhdukur, por sfidat mbeten në identifikimin e mbi 1,600 personave të zhdukur, duke përfshirë identifikimin e gabuar të trupave si dhe angazhimin politik në Serbi për hetim të besueshëm dhe transparent të fatit të të gjithë personave të zhdukur.⁹ Mbetet për t'u parë nëse dialogu aktual i udhëhequr nga BE midis Kosovës dhe Serbisë do të kontribuojë në zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur. Përpjekjet për të kujtuar dhe dokumentuar ngjarjet, perspektivat dhe përvojat e konfliktit janë dominuar kryesisht nga narrativat mono-etnike dhe interesat dritëshkurtër të elitave politike. Për të kompensuar këto mangësi, një numër i vogël i organizatave të shoqërisë civile kanë qenë në ballë të promovimit të qasjeve qytetare dhe gjithëpërfshirëse për të treguar të vërtetën, dokumentimin dhe mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarve dhe avokimin për pajtimin etnik. Pas konsensusit politik në nivelin rajonal dhe kombëtar, fati i iniciativave të tilla si KOMRA ose Komisioni i Vërtetës dhe Pajtitimit i ish Presidentit të Kosovës, mbeten të pasigurta dhe me ndikim të kufizuar.

Gjatë administrimit ndërkombëtar të Kosovës, çështja e dëmshpërblimit për krimet e luftës dhe dëmet e tjera u anashkalua kryesisht dhe në vend të kësaj fokusi ishte në trajtimin e problemeve më të ngutshme me kthimin e refugjatëve, zgjidhjen e pronave të kontestuara dhe shqetësime të tjera të sigurisë së pakicave etnike. Që atëherë, institucionet e Kosovës kanë hartuar një skemë të gjerë të ndihmës sociale për 12 kategori të ndryshme shoqërore të prekura nga konflikti.¹⁰ Vetëm pasi një grup i OJQ-ve me bazë në Kosovë¹¹ me mbështetjen e qeverisë britanike u mobilizua për të kërkuar dëmshpërblim për gratë viktimat civile dhe të mbijetuarat, Qeveria e Kosovës është përgjigjur dhe ka krijuar infrastrukturën ligjore dhe institucionale për të identifikuar dhe mbështetur viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit. Serbia, nga ana tjetër, deri më tani ka siguruar kompensim për një numër të vogël të rasteve individuale. Midis 2006 dhe 2010, Qendra për të Drejtën Humanitare me bazë në Beograd ka ngritur 52 procese gjyqësore kundër Serbisë, duke kërkuar kompensimin për 188 viktimat të luftës në Kosovë.¹² Përkundër këtyre përpjekjeve të kufizuara, Serbia nuk ka në plan të shikojë të ofrojë kompensim të gjerë dhe gjithëpërfshirës për dëmet e shkaktuara në kohë luftime në Kosovë.

Si rezultat i këtyre dinamikave, përpjekjet për krijimin e garancive institucionale për mospërsëritjen e konfliktit kanë qenë simbolike, të njëanshme dhe kanë kaluar kryesisht pa u vënë re pavarësisht investimeve të konsiderueshme legislative dhe institucionale në ndërtimin e paqes, të drejtat e pakicave dhe ndarjen e pushtetit. Një përpjekje e madhe për hartimin e një strategjie kombëtare për drejtësinë tranzicionale ndodhi pas pavarësisë së Kosovës në 2008, e mbështetur nga UNDP, por përfundoi e pasuksesshme. Në vitin 2012, u krijua një Grup Pune Ndërmnistror për Trajtimin e së Kaluarës dhe Pajtimin (IMWG-DwPR) roli i të cilit ishte të merrte "parasysh pikëpamjet e viktimave të të gjitha komuniteteve në Kosovë", që do të futej në një Strategji Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale.¹³ IMWG-DwPR

⁹ Kathrynne Boomerger dhe Matthew Holliday, 'Serbia, Kosova, Duhet të Angazhohen për Hetimet e Personave të Zhdukur të Besueshëm', 09 shtator 2020, BIRN, Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë. Në dispozicion: <https://balkaninsight.com/2020/09/09/serbia-kosovo-must-commit-to-credible-missing-persons-investigations/?fbclid=IwARlAy-mZsB-jzDw9310UWKVEoIq8YvccbFp8brCXn2NF7bMQnlEu3Mr3yWA>

¹⁰ TKategoritë e përfshirjes përfshijnë: familjet e dëshmorëve; personat e zhdukur të familjeve të UÇK-së; invalidët e luftës; Invalidë me një kujdestar; familjet e invalidëve të luftës pas vdekjes; familjet e viktimave civile; familjet e personave të zhdukur; invalidët civilë të luftës; familjet e invalidëve civilë pas vdekjes; veteranë; dhe viktimat e dhunës seksuale.

¹¹ Iniciativa u drejtua nga ai Qendra e rehabilitimit të Kosovës për viktimat e torturës (QKRMT), Qendra për promovimin e të drejtave të grave dhe Medica Kosova. ¹² Dardan Hoti, 'A mund të marrë Kosova shpajm për shkatërrimet e kohës së luftës?', BIRN, 6 nëntor 2019 Prishtinë, Kosovë. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2019/11/06/can-kosovo-get-payback-for-wartime-devastation/> ¹³ Qeveria e Kosovës, 'Projektvendimi për Themelimin e Grupit Punues Ndërmnistror për Trajtimin e së Kaluarës dhe Pajtimin', Dok. Nr. 03/77, 04 qershor 2012, f. 3

përbëhej nga përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, përfshirë njerëz nga komunitetet pakicë. Sidoqoftë, në vitin 2018, IMWG-DwPR zyrtarisht pushoi së funksionuari pasi dështoi të zhvillonte një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale. Kjo iniciativë dështoi si rezultat i dy faktorëve të ndërlidhur: a) mungesa e vullnetit politik në mesin e Qeverisë së Kosovës dhe mungesa e presionit nga bashkësia ndërkombëtare për të dhënë këtë iniciativë; dhe b) mungesa e kapaciteteve, burimeve dhe përfaqësimit adekuat brenda IMWG-DwPR që dëmtonte aspektet përgatitore dhe operacionale.¹⁴ Kohët e fundit, në një përpjekje për të trajtuar çështjen e neglizhuar të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka themeluar Departamentin për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit, funksioni kryesor i të cilit është të propozojë politika dhe akte normative në lidhje me fushën e drejtësisë tranzicionale.¹⁵ Mbetet për t'u parë nëse ky organ i ri institucional do të jetë në gjendje të kapërcejë mungesën e vullnetit politik dhe kapacitetit mes të gjithë aktorëve për t'u angazhuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sistematike me trashëgiminë e së kaluarës, të cilat vazhdojnë t'i minojnë ndjeshëm përpjekjet për vendosjen e drejtësisë për të gjitha viktimat, të zgjidhin dhe të pajtojnë çështjet e pazgjidhura dhe të krijojnë struktura për të mbështetur paqen e qëndrueshme dhe ecjen përpara si shoqëri.

Mungesa e një qasjeje serioze dhe gjithëpërfshirëse për t'u marrë me të kaluarën rrezikon të zgjasë edhe më tej iniciativat ad hoc dhe selektive, të cilat tentojnë t'i përshtaten grupeve specifike shoqërore dhe etnike dhe të përjashtojnë komunitetet e tjera të prekura në Kosovë. Deri më tani, studime të ndryshme kanë treguar se përpjekjet për të trajtuar të kaluarën në Kosovë shihen si një-dimensionale, përkatësisht secili grup etnik percepton punën e gjykatave të krimeve të luftës, iniciativat e kërkimit të së vërtetës dhe dëmshpërblimet për viktimat si masa të drejtuara për përfitimin e një grupi etnik dhe jo të të tjerëve.¹⁶ Opinioni publik në Kosovë mbetet shumë i ndarë përgjatë vijave etnike kur bëhet fjalë për drejtësinë tranzicionale dhe ekziston një hendek i konsiderueshëm i perceptimeve mes të gjitha grupeve etnike mbi historinë dhe ngjarjet e konfliktit, mbi përgjegjësinë për krimet e luftës dhe mbi atë se kush është viktimizuar, mbi të drejtat për viktimat, të mbijetuarit dhe komunitetet e prekura, si dhe mbajnë pikëpamje të kundërta mbi atë se si të merren me të kaluarën dhe të shkojnë përpara. Prandaj, seksionet procedurale të këtij studimi ofrojnë një pasqyrë të perspektivës së qytetarëve dhe nxjerrin në pah arsyen pse një strategji për drejtësinë tranzicionale në Kosovë është e vonuar.

¹⁴ Nora Ahmetaj dhe Thomas Unger, *Korniza e Kosovës për Trajtimin e së Kaluarës në një pikë kthese: Rishikimi i shoqërisë civile i progresit drejt Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale*, PAX, Integra, Impunity Watch, CPT, 2017, Prishtinë, Kosovë. ¹⁵ Qeveria e Kosovës, 'Rregullorja GRK - Nr. 12/2018 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores GRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë', 31 korrik 2018. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17792>. ¹⁶ Visoka dhe Lumi, *Demokratizimi i Drejtësisë Tranzicionale*

3. Qëllimi dhe parimet e një strategjie të ardhshme për drejtësinë tranzicionale

Thelbësor për strategjinë e ardhshme për drejtësinë tranzicionale është përcaktimi i qëllimit, fushës dhe parimeve që do të drejtojnë procesin e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit. Gjetjet nga ky hulumtim tregojnë se nuk ka konsensus ndërmjet të gjitha grupeve etnike në Kosovë se çfarë do të thotë drejtësi tranzicionale dhe cili duhet të jetë qëllimi dhe fushëveprimi i një strategjie të ardhshme. Vendndodhja gjeografike, prejardhja etnike dhe sfondi personal i pjesëmarrësve kanë ekspozuar një gamë të gjerë preferencash dhe perceptimesh mbi atë se cili duhet të jetë qëllimi, parimet dhe përparësitë e një strategjie të ardhshme të drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Secili komunitet e përcakton veten si viktimë të konfliktit. Shqiptarët e Kosovës duan të merren me të kaluarën ndërsa serbët e Kosovës më së shumti duan të merren me periudhën pas konfliktit. Grupet e tjera etnike në mënyrë të ngjashme dëshirojnë që zëri dhe perspektivat e tyre të dëgjohen dhe të përfshihen në proceset tranzicionale të drejtësisë në Kosovë.¹⁷ Ky qëndrim i bazuar në identitet ndaj konfliktit dhe trashëgimisë së tij ka implikime të gjera mbi atë që quhet viktimë dhe mbi atë se kush janë komunitetet e prekura, cilat janë përparësitë dhe çështjet e ngutshme që duhet të adresohen dhe sa e mundshme është që të gjinden baza të përbashkëta për ndërtimin e paqes dhe pajtimin përmes perspektivave të ndryshme mbi drejtësinë tranzicionale.

Midis pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës ekziston një konsensus i gjerë mbi atë që duhet të mbulojë një strategji e ardhshme. Ata kanë ndarë gjerësisht pikëpamjen se ndjekja penale e të dyshuarve për krime lufte duhet të mbetet thelbësore në përpjekjet e ardhshme për drejtësinë tranzicionale, e ndjekur më pas me adresimin e nevojave të ngutshme të familjeve të personave të zhdukur, të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit dhe të plagosurve dhe personave me aftësi të kufizuara gjatë konfliktit. Shumica dërmuese e pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës, veçanërisht të rinjtë, kanë argumentuar se identifikimi i eshtrave të personave të rrëmbyer dhe të zhdukur është çështja më e rëndësishme në të cilën duhet të përqendrohet strategjia e ardhshme për drejtësinë tranzicionale.¹⁸ Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrësit kanë ngritur rëndësinë e rritjes së mbështetjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë në trajtimin e problemeve të tyre psikologjike dhe shëndetësore, ndërsa fuqizimi i tyre ekonomik shihet si kyç për tejkalimin e stigmës dhe përjashtimit social. Përveç këtyre çështjeve, pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë sjellë rëndësinë e trajtimit të mosmarrëveshjeve mbi pronësinë e pronës dhe kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit si dhe dëmshpërblimet për dëmet në kohë lufte si një masë e drejtësisë materiale.¹⁹

Megjithatë, ekziston skepticizëm mbi kapacitetin dhe vullnetin e Qeverisë së Kosovës për t'u marrë me të kaluarën përmes një strategjie kombëtare, si dhe ekziston frika se mosfunksionimi i bashkësisë ndërkombëtare përmes gjykatave hibride dhe mungesa e bashkëpunimit nga Serbia do të minojë përpjekjet e ardhshme për trajtimin e së kaluarës. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë ngritur si shqetësim relativizimin e dhënies së përgjegjësive për krimet e luftës në Kosovë, duke deklaruar se me kalimin e viteve identiteti, qëllimi dhe roli i aktorëve përgjegjës për krimet e luftës dhe mizoritë në Kosovë janë shtrembëruar, nga të cilat shpesh keqbërësit kanë dalë si viktima dhe anasjelltas.²⁰ Një kërkim-falje zyrtare nga Serbia për krimet e luftës të

¹⁷ Intervista B, 17 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë.. ¹⁸ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ¹⁹ Po aty. ²⁰ Fokus Grupi 4, 17 gusht 2020, rajoni i Pejës, Kosovë.

kryera në Kosovë gjatë luftës përshkruhet nga shqiptarët e Kosovës si një faktor kontribues për paqen dhe pajtimin në rajon. Kështu, për ta qëllimet e një strategjie të ardhshme duhet të jenë zbulimi i së vërtetës dhe atribuimi i përgjegjësisë për krimet e luftës në Kosovë si një parakusht për zgjidhjen e problemit të konfliktit dhe trashëgimisë së tij.

Mes shqiptarëve të Kosovës, nevoja dhe rëndësia e një strategjie për drejtësinë tranzicionale është e padiskutueshme. Sidoqoftë, në mesin e serbëve të Kosovës ekziston skepticizëm i gjerë, ngurrim dhe mbështetje e kushtëzuar për një strategji të tillë. Pjesëmarrësit serbë kanë pak besim në proceset e drejtësisë tranzicionale dhe shpesh i lidhin këto me politika të fuqive të mëdha dhe i shohin ato si fushata të synuara të shteteve perëndimore.²¹ Për ta, drejtësia tranzicionale nuk shoqërohet me të vërtetën, drejtësinë dhe paqen por me atribuimin e fajit, politikën e pushtetit dhe interesat strategjikë. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit serbë të Kosovës kanë treguar që pranimi i një strategjie të tillë varet kryesisht nga vullneti politik dhe shkalla në të cilën perspektiva serbe për luftën, atribuimin e përgjegjësisë dhe viktimat njihen dhe merren parasysh.²² Ekziston gjithashtu ngurrim për t'u angazhuar me të kaluarën për shkak të mundësisë së dhënies së fajit dhe përgjegjësisë për padrejtësitë e së kaluarës, të cilat mund të rezultojnë në minimin e statusit të tyre aktual dhe delegjitimimin e kërkesave të tyre dhe minimin e prioriteteve politike. Për më tepër, komuniteti serb i Kosovës e sheh pranimin e të kaluarës si të lidhur me njohjen socio-ekonomike dhe gjuhësore në të tashmen.²³ Me fjalë të tjera, komuniteti serb i Kosovës ngurrin të merret me të kaluarën pa siguruar që të drejtat e tyre politike, ekonomike dhe socio-gjuhësore të mbrohen dhe zbatohen në Kosovë.²⁴ Përkundrazi, midis tyre ka një theks më të madh në kërkimin e drejtësisë për çështjet aktuale se sa trajtimi i ngjarjeve të kohës së luftës dhe trashëgimisë së konfliktit. Ka më shumë preokupim me jetën e përditshme dhe sfidat që ndikojnë në komunitetin e tyre dhe asnjë ndjenjë historie të përbashkët, vuajtjesh ose përvojash të së kaluarës me komunitetet e tjera etnike.²⁵

Pavarësisht nga këto pikëpamje dhe dilema divergjente, një shumicë e pjesëmarrësve në të gjitha bashkësitë etnike kanë theksuar se një strategji e ardhshme për drejtësinë tranzicionale dhe trajtimin e të kaluarës duhet të zhvillohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese dhe duhet të marrë parasysh nevojat e të gjitha komuniteteve të prekura në Kosovë pavarësisht statusit të tyre etnik. Një i intervistuar theksoi transparencën dhe drejtësinë si parimet kryesore udhëzuese:

"Një nga vlerat themelore, që unë mendoj se institucionet duhet të ndjekin dhe të bazohen në të, është transparenca dhe pastaj duhet të jetë drejtësia dhe shmangia e favorizimit të grupeve të caktuara ndaj të tjerëve."²⁶

Të anketuarit gjithashtu kanë theksuar rëndësinë e promovimit të barazisë ndërmjet të gjitha komuniteteve të prekura, gjë që përfshin respekt dhe konsideratë adekuate për nevojat dhe interesat e tyre. Siç deklaroi një pjesëmarrës nga familjet e personave të zhdukur shqiptarë të Kosovës:

"Barazi do të thotë barazi për të gjithë ... do të thotë të ofrosh zgjidhje të barabarta për të gjithë pa dallime."²⁷

Një thirrje për përfshirje dhe barazi është gjithashtu mbizotëruese në mesin e pakicave etnike jo-dominante në Kosovë. Siç deklaroi një aktivist rom i Kosovës:

²¹ Fokus Grupi 8, 18 gusht 2020, në tërë Kosovën. ²² Fokus Grupi 7, 12 gusht 2020, rajoni i Gjilanit, Kosovë. ²³ Fokus Grupi 9, 01 shtator 2020, Mitrovica e Veriut, Kosovë.

²⁴ Fokus Grupi 7, 12 gusht 2020, rajoni i Gjilanit, Kosovë. ²⁵ Fokus Grupi 9, 01 shtator 2020, rajoni i Pejës, Kosovë. ²⁶ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë.

²⁷ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën.

*"Ka shumë rëndësi që të përfshihen të gjitha pakicat etnike në çdo proces tranzitor të drejtësisë. Fatkeqësisht, deri më tani, fokusi ishte vetëm tek shqiptarët dhe serbët, ndërsa pakicat e tjera etnike janë lënë jashtë bisedës, madje edhe nga donatorët dhe institucionet. Nuk ka asnjë rrëfim nga lufta për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, askush nuk i sheh ata si viktimat. Viktimat e këtyre komuniteteve duhet të dëgjohen."*²⁸

Në mënyrë të ngjashme, një pjesëmarrës boshnjak shtoi:

*"Strategjia duhet të përqendrohet në aspekte që nuk janë hulumtuar dhe që kanë të bëjnë direkt ose indirekt me viktimat e komunitetit boshnjak në periudhën nga 1998 në 2000. Prioritet duhet të jetë drejtësia për viktimat."*²⁹

Shumica e të anketuarve kanë argumentuar se një strategji e ardhshme për drejtësinë tranzicionale duhet të hartohet me pjesëmarrjen e komuniteteve të prekura dhe të orientohet drejt adresimit të nevojave dhe shqetësimeve të viktimave dhe të mbijetuarve. Një turk i Kosovës deklaroi: "të gjitha pakicat në Kosovë duhet të mbështeten kur bëhet fjalë për forma të drejtpërdrejta ose indirekte të pjesëmarrjes siç janë fazat e konsultimit dhe monitorimit në strategjinë e ardhshme për drejtësinë tranzicionale në Kosovë".³⁰ Në veçanti, ekziston një konsensus tek të gjithë se një strategji e ardhshme duhet të synojë të përmirësojë jetën e qytetarëve me një fokus tek viktimat dhe të mbijetuarit dhe të hap rrugën për një të ardhme në të cilën incidentet e të kaluarës nuk do të ndodhin më. Siç deklaroi një pjesëmarrës shqiptar i Kosovës:

*"Në fund të fundit, qëllimi përfundimtar i kësaj strategjie duhet të jetë përmirësimi i mirëqenies fizike dhe mendore të të gjitha komuniteteve të prekura, pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik dhe prejardhja etnike."*³¹

Për më tepër, qytetarët kanë theksuar rëndësinë e asaj se një strategji e ardhshme duhet t'i japë fund fokusit të pabalancuar dhe të drejtës për të qenë i vuajtur në të kaluarën që u ofrohen vetëm një grupi të ngushtë të kategorive etnike dhe shoqërore në Kosovë. Agjenda e ardhshme për drejtësinë tranzicionale duhet të shkojë paralelisht me drejtësinë socio-ekonomike për të gjitha bashkësitë etnike në Kosovë.³² Kështu, një strategji e ardhshme duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të promovojë përfshirjen dhe të sigurojë që zëri dhe nevojat e të gjitha komuniteteve të prekura të merren parasysh dhe të përkthehen në mbështetje institucionale. Pjesëmarrësit kanë argumentuar se qasja më e përshtatshme në adresimin e çështjeve dhe trashëgimisë së të kaluarës në Kosovë duhet të jetë një qasje nga poshtë-lart duke filluar nga familjet e viktimave dhe të mbijetuarve, te këshillat e fshatrave, komunat, tek niveli qendror dhe tek gjykatat. Ekziston një ngurrim midis qytetarëve që nëse një strategji e ardhshme dominohet nga proceset nga lart-poshtë dhe është shkruar vetëm për t'iu përshtatur agjendës së liderëve politikë në Kosovë, ka të ngjarë të prodhojë efekte të kufizuara. Për këtë arsye, ata bënë thirrje për një qasje të kombinuar nga poshtë-lart dhe lart-poshtë në zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie të tillë. Në veçanti, komunitetet e prekura duhet të përfshihen drejtpërdrejt dhe të përfitojnë nga strategjia e ardhshme dhe të përfaqësohen drejtpërdrejt në përpjekjet e ardhshme sesa përmes strukturave të tjera që shpesh nuk kanë qenë në gjendje të përfaqësojnë komunitetet e prekura. Diversiteti i perceptimeve është një dëshmi se vetëm një qasje nga poshtë-lart, gjithëpërfshirëse dhe inkluzive për hartimin e strategjisë së ardhshme ka të ngjarë të ofrojë mundësi të barabarta për të gjitha komunitetet e prekura dhe kështu të rris legjitimitetin e një procesi të tillë të vonuar.

²⁸ Intervista B, 17 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ²⁹ Intervista F, 24.11.2020, Mitrovica, Kosovë. ³⁰ Interview C, 18.11.2020, Prishtina, Kosovo.

³¹ Focus Group 2, 11 August 2020, Prishtina region, Kosovo. ³² Interview E, 23.11.2020, Gracanica, Kosovo.

4. Shtyllat kryesore të një strategjie të ardhshme për drejtësinë tranzicionale

Perspektivat e qytetarëve për ato që duhet të jenë çështjet kryesore dhe përparësitë nën një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e së kaluarës janë grupuar në katër shtylla kryesore, siç përshkruhen më poshtë, dhe të gjitha këto konsiderohen njësoj të rëndësishme për adresimin e trashëgimisë të së kaluarës në Kosovë.

4.1 Kërkimi i së vërtetës

Zbulimi i së vërtetës në lidhje me krimet e kohës së luftës dhe abuzimet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut si dhe dokumentimi dhe përkujtimi i ngjarjeve dhe përvojave adekuata të të gjitha komuniteteve të prekura konsiderohen thelbësore nga pjesëmarrësit në këtë studim për trajtimin e së kaluarës dhe drejtësisë tranzicionale. Deri më tani në Kosovë, përpjekjet për të kërkuar të vërtetën kanë ndodhur në baza ad hoc dhe kryesisht përmes projekteve të shoqërisë civile. Nuk ka pasur ndonjë qasje sistematike, të koordinuar dhe strategjike për dokumentimin dhe shpërndarjen e ngjarjeve, provave dhe përvojave të komuniteteve të prekura. Njohja e qytetarëve të cilët ishin të përfshirë në këtë hulumtim në lidhje me ngjarjet e së kaluarës ishte kryesisht anekdotale, shpesh me shifra të pasakta dhe të mbingarkuara të viktimave dhe llojeve të krimeve të luftës të kryera. Ne kemi vërejtur një gamë të gjerë mendimesh të papajtueshme në lidhje me përpjekjet e institucioneve të Kosovës dhe shoqërisë civile në trajtimin e trashëgimisë së konfliktit në Kosovë. Ajo që zbulojnë diskutimet e grupeve të fokusit është se ka shumë pak ndjeshmëri dhe kuptim të perspektivave dhe përvojave të njëri-tjetrit, të konfliktit dhe çështjeve të ngutshme që ndikojnë në jetën dhe aftësinë e tyre për të ecur përpara dhe për t'u pajtuar me të kaluarën. Në vend të kësaj, provat janë të qarta se nëpër të gjitha bashkësitë etnike ekziston një rrëfim pothuajse si skenar i shkruar për të kaluarën dhe për atë se cilat janë çështjet e ngutshme të cilat duhet të trajtohen në strategjinë e ardhshme. Një njohuri e tillë e kufizuar e së vërtetës për ngjarjet e kaluara lë të hapur mundësinë për të mos njohur fakte të vlefshme për të kaluarën, të cilat mund të çojnë në ndërtimin e rrëfimeve të pasakta, me shikim të brendshëm e me pasoja të gjera për komunitetet e prekura dhe për perspektivën për ndërtimin e paqes dhe të pajtimit.

Shumica e qytetarëve theksuan rëndësinë e kërkimit të së vërtetës por gjithashtu pranuan që e vërteta perceptohet ndryshe midis secilit grup etnik. Secili komunitet është i predispozuar të kërkojë, të përkujtojë dhe të dokumentojë të vërtetën mono-etnike të së kaluarës. Ka pak hapësirë për të kërkuar terrene të përbashkëta ose për krijimin e hapësirave të përbashkëta qytetare për t'u marrë me të kaluarën. Disa nga pjesëmarrësit kanë ndarë mendimin se dakordimi për një të vërtetë të përbashkët për të kaluarën është shumë i vështirë, nëse jo i pamundur, duke theksuar se një e vërtetë e ndryshme po rrëfëhet nga secili komunitet. Midis disa prej pjesëmarrësve serbë kishte mendime se zbulimi i së vërtetës në lidhje me konfliktin është problematik pasi mund të rezultojë në atribimin dhe kolektivizimin e fajit për krimet e luftës në të kaluarën dhe abuzimet serioze të të drejtave të njeriut për të gjitha grupet etnike.³³ Në veçanti, në mesin e serbëve të Kosovës ekziston një perceptim mbizotërues për t'i konsideruar të gjitha bashkësitë etnike në Kosovë si viktimë të konfliktit, duke sjellë kështu ngjarjet, përvojat dhe trashëgiminë e para, gjatë dhe pas konfliktit në një fushë të barabartë loje. Siç deklaroi një i ri serb i Kosovës:

³³ Fokus Grupi 8, 17 gusht 2020, në tërë Kosovën.

"Unë mendoj se do të lindte kaos i plotë nëse e vërteta totale do të dilte në dritë, sepse unë mendoj se të dy kombet jetojnë në keqkuptime për shumë krime që kanë kryer."³⁴

Komunitetet e tjera etnike kanë sjellë sfida të ndryshme me të cilat përballen në dokumentimin e abuzimeve të kaluara të të drejtave të njeriut dhe kërkimin e drejtësisë për viktimat e tyre, përfshirë frikën e hakmarrjes dhe pasojat për komunitetet e tyre. Siç deklaroi një pjesëmarrës ashkali:

"Minoritetet hezitojnë të raportojnë shkeljet ndaj tyre sepse nuk u besojnë institucioneve dhe nuk raportojnë krimet e së kaluarës për shkak të frikës nga hakmarrja ndaj tyre... Minoritetet janë përpjekur në vitet 1999-2000 të raportojnë disa krime, por me qenë se nuk ishte bërë asgjë, ata humbën besimin në proces."

Në mënyrë të ngjashme, një pjesëmarrës rom shtoi se:

"Frika është faktor kryesor në hezitimin e pakicave për të dalë përpara për t'i treguar historitë e tyre. Shteti i ka dështuar ata në shumë raste në ndjekjen e drejtësisë, kështu që ata kanë humbur besimin te shteti dhe te drejtësia."³⁵

Një çështje tjetër e diskutueshme midis komuniteteve dominuese është përcaktimi i periudhës kohore të konfliktit dhe spektri i krimeve të kryera. Në veçanti, ekziston një tendencë midis komunitetit shqiptar dhe serb për të identifikuar çështjet dhe afatet kohore të cilat portretizojnë një komunitet si viktimë dhe tjetrin si autorë dhe anasjelltas. Ne vumë re se midis pjesëmarrësve serbë kishte një mungesë të dukshme të komenteve për krimet e kryera nga policia serbe, forcat ushtarake dhe paraushtarake kundër civilëve shqiptarë të Kosovës dhe kryesisht diskutimi u përqëndrua në periudhën pas konfliktit dhe ndjenjën mbizotëruese të padrejtësisë ndaj komunitetit të tyre. Në mënyrë të ngjashme, midis pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës theksi i diskutimit ishte në trashëgiminë dhe çështjet e pazgjidhura nga periudha e kohës së luftës dhe jo aq shumë në periudhën pas konfliktit ose padrejtësitë e përjetuara nga komunitetet e tjera etnike. Për më tepër, të dy bashkësitë kanë normalizuar narrativat totale për të kaluarën. Në mesin e shqiptarëve të Kosovës nuk përmenden viktimat serbe ose pakicë të konfliktit, ndërsa komuniteti serb tenton të kontestojë ose minimizojë krimet e kryera kundër shqiptarëve civilë. Midis pjesëmarrësve serbë kishte një rezistencë të dukshme dhe mosgatishmëri për të njohur shqiptarët e Kosovës si viktima të krimeve të kryera nga policia dhe forcat ushtarake serbe gjatë konfliktit. Përkundrazi, ekziston një perceptim i përhapur mes pjesëmarrësve serbë të Kosovës se "viktimat janë serbë dhe pakica të tjera etnike...", dhe jo shqiptarë të Kosovës.

Midis komuniteteve tjera ekziston një perceptim i fuqishëm se rrëfimi i tyre për të kaluarën, përvojat dhe nevojat e tyre heshten plotësisht nga komunitetet dominuese dhe nuk merren parasysh gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Në veçanti, ata sollën të drejtën për të ditur për fatin e personave të zhdukur në mesin e komuniteteve pakicë. Një aktivist rom i Kosovës deklaroi se "drejtësia tranzicionale aktualisht nuk ekziston" për komunitetin e tyre, duke shtuar se:

"Ekziston një mungesë e shkëmbimit të informacionit me familjet e personave të zhdukur, mungesa e qasjes në mekanizmat për sigurimin e drejtësisë tranzicionale si dhe diskriminimi i përgjithshëm që hasen nga familjet e personave të zhdukur dhe/ose familjet që janë ende në pritje për ta ditë fatin e të dashurve të tyre."³⁷

³⁴ Po aty. ³⁵ Intervista B, 17 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ³⁶ Fokus Grupi 10, 02 shtator 2020, rajoni i Mitrovicës, Kosovë. ³⁷ Intervistë E, 23 nëntor 2020, Graçanicë, Kosovë

Dokumentimi i ngjarjeve të kohës së luftës dhe zbulimi i fatit të personave të zhdukur u paraqit pothuajse në çdo diskutim dhe bisedë në fokus grup me individë aktivistë të komunitetit. Megjithëse ekziston një marrëveshje e përbashkët që kërkimi dhe gjetja e së vërtetës është një detyrë shumë e vështirë, shumica e pjesëmarrësve theksuan nevojën që viktimat të dëgjohen dhe kujtimet e tyre të dokumentohen siç duhet nga institucionet qeveritare. Ndërsa shumica e trupave të personave të zhdukur gjatë konfliktit janë identifikuar, fati i mbi 1,600 personave të zhdukur mbetet ende i panjohur. Sfida kryesore në identifikimin e trupave të personave të zhdukur që nga përfundimi i konfliktit mbetet vullneti politik i të gjithë të përfshirëve për të bashkëpunuar me mirëbesim për të adresuar pengesat ekzistuese. Midis familjeve të personave shqiptarë të zhdukur ka një zhgënjim të madh me procesin e ngadaltë dhe joefikas të identifikimit të trupave të personave të zhdukur gjatë dhe pas luftës, si dhe me mungesën e vullnetit politik të udhëheqësve politikë në Serbi, BE dhe vendet e tjera të treta, si edhe në Qeverinë e Kosovës për të adresuar seriozisht dhe vendosmërisht këtë problem të zgjatur dhe të vonuar në Kosovë.³⁸ Një pjesëmarrës rom i bëri jehonë të njëjtit shqetësim: "kërkimi i së vërtetës është shumë i rëndësishëm, shumica e familjeve që janë ende në pritje të drejtësisë po jetojnë në një flluskë që ende nuk e dinë se çfarë ka ndodhur me të dashurit e tyre".³⁹ Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës në veçanti, kanë bërë presion që dispozitat mbi personat e zhdukur duhet të merren parasysh gjatë bisedimeve të lehtësuara nga BE me Serbinë dhe duhet të jenë një tipar thelbësor i një zgjidhjeje përfundimtare të paqes.⁴⁰

Shumica e pjesëmarrësve kanë renditur çështje të tilla si narrativat, arkivat, muzetë për luftën, dhe librat shkollorë të historisë dhe mësimet si mjete të rëndësishme për të promovuar të vërtetën për luftën. Në mënyrë të veçantë ata theksuan nevojën për të diskutuar më thellë në lidhje me luftën dhe trashëgiminë e së kaluarës në shkollat në të gjithë vendin. Siç deklaroi një pjesëmarrës shqiptar i Kosovës:

*"Fokusi duhet të jetë në arsim, në mësimdhënien e një historie të bazuar në fakte, e cila do të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve dhe studentëve për atë që ka ndodhur në të vërtetë në Kosovë."*⁴¹

Një pjesëmarrës ashkali shtoi se për komunitetin e tyre një problem kryesor mbetet "mungesa e njohurive mbi të drejtat e tyre dhe mbi kornizën ekzistuese ligjore që mbron të drejtat e pakicave", duke e konsideruar atë "një pasojë e mungesës së arsimit adekuat dhe mungesës së vetëdijes".⁴²

Pjesëmarrësit gjithashtu kanë theksuar rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të programeve të veçanta dëshmuese ku komunitetet e prekura mund të ndajnë dhe dokumentojnë përmes mjeteve audio-vizuale përvojat e tyre të konfliktit dhe të lënë prova për brezat e ardhshëm për të mësuar rreth së kaluarës.⁴³ Siç deklaroi një pjesëmarrës shqiptar i Kosovës:

*"Unë mendoj se do të ishte e dobishme që njerëzve që kanë vuajtur më shumë nga lufta t'u jepet një hapësirë e sigurt ku ata mund të ndajnë përvojat e tyre dhe të sigurohen që brezat e ardhshëm të mos e harrojnë të kaluarën e tyre."*⁴⁴

Përveç rëndësisë së dokumentimit të viktimave njerëzore në kohë lufte, pjesëmarrësit kanë ngritur çështjen e neglizhuar të dokumentimit të dëmeve kulturore dhe materiale të ndodhura gjatë konfliktit dhe duke vlerësuar kështu koston ekonomike të luftës.⁴⁵ Në një nivel individual, pjesëmarrësit serbë dhe shqiptarë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për t'u

³⁸ Fokus Grupi 1, 11 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ³⁹ Intervistë E, 23 nëntor 2020, Graçanicë, Kosovë. ⁴⁰ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë.

⁴¹ Fokus Grupi 4, 17 gusht 2020, rajoni i Pejës, Kosovë. ⁴² Intervista A, 16 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ⁴³ Po aty. ⁴⁴ Po aty. ⁴⁵ Fokus Grupi 1, 11 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë.

angazhuar dhe ditur më shumë për përvojat dhe perspektivat e palëve të tjera në lidhje me luftën. Një pjesëmarrës serb i Kosovës reflekton:

*"Ka shumë rëndësi ta pranosh dhe ta njohësh të vërtetën ... Dua të them, unë personalisht nuk e di se çfarë ... Cilat janë viktimat në anën tjetër, unë nuk kam dëgjuar ose parë, kështu që as nuk mund të flas ... Unë nuk di për shumicën e viktimave nga ana jonë."*⁴⁶

Pjesëmarrësit nga të gjitha komunitetet kanë shprehur dëshirën e tyre që një strategji e ardhshme të shërbejë si një platformë ku historitë, përvojat dhe ngjarjet e tyre që simbolizojnë vuajtjet, viktimat dhe sakrificat të njihen nga pala tjetër si një parakusht për trajtimin e duhur të së kaluarës dhe ndërtimin e një të ardhme të begatë. Siç deklaroi një pjesëmarrës goran: "e vërteta e mirfilltë duhet të dihet, pa marrë parasysh sa e vështirë mund të jetë".⁴⁷ Megjithatë, pjesëmarrësit kanë theksuar pengesa të ndryshme politike dhe strukturore që mund të parandalojnë një angazhim të tillë, duke përfshirë mosmarrëveshjet në nivelin më të lartë politik si dhe çështje të shumta të pazgjidhura që prekin ndryshe secilin komunitet. Sidomos, në mesin e pjesëmarrësve të të rinjve serbë të Kosovës, njohja e viktimave dhe shkarkimi i fajit dhe përgjegjësisë kolektive për keqbërjet e kaluara shihet si thelbësore për të ecur përpara dhe për të rifilluar marrëdhëniet me shqiptarët e Kosovës.⁴⁸ Në mesin e shqiptarëve të Kosovës, u vërejt se dokumentimi i duhur i krimeve të luftës që ndodhën në Kosovë është përgjegjësi e institucioneve shtetërore, ndërsa serbët e Kosovës ishin më ngurrues pasi ata ende nuk i njohin plotësisht dhe nuk u besojnë institucioneve të Kosovës.⁴⁹

4.2 Gjykatat e krimeve të luftës

Kërkimi i drejtësisë për krimet e luftës përmes gjykatave dhe proceseve gjyqësore konsiderohet thelbësor për mbyllje të kontesteve dhe për dhënien e përgjegjësisë për krime të tilla të rënda, si dhe ofrimin e mbylljes dhe një masë të drejtësisë për viktimat, të mbijetuarit dhe komunitetet e tjera të prekura. Derisa ekziston një konsensus se drejtësia duhet t'u shërbehet viktimave, ekzistojnë dyshime nëse sistemi i drejtësisë penale është një zgjidhje e vlefshme. Secila bashkësi etnike ka perceptim negativ të gjykatave dhe gjykimeve për krime të luftës në Kosovë dhe i konsideron ato joefikase dhe që marrin në shënjestër në mënyrë selektive anëtarët e komunitetit të tyre etnik. Mes pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës, gjyqet e krimeve të luftës shihen si qasja më e rëndësishme për t'u marrë me të kaluarën në Kosovë dhe për të sjellë drejtësi për viktimat dhe për të mbijetuarit. Ekziston një konsensus i fuqishëm që ata që kanë kryer krime luftime duhet të ndiqen penalisht dhe të sillen para drejtësisë. Gjyqe të tilla shihen si strategjia më e zbatueshme gjithashtu për të siguruar që autorët (në këtë rast, institucionet shtetërore serbe dhe individët serbë) do të pajtohen me të vërtetën, të pranojnë përgjegjësinë dhe të kërkojnë falje për krime të tilla të rënda, dhe të paguajnë dëmshpërblime për njerëz dhe për dëmet materiale.⁵⁰

Megjithë këtë, në mesin e shqiptarëve të Kosovës ekziston frika se numri i ulët i çështjeve të hetuara dhe procedurat e zgjatura gjyqësore po vonojnë drejtësinë për viktimat dhe të mbijetuarit.⁵¹ Ekziston frika se sa më shumë kohë që kalon dhe krimet e luftës trajtohen keq, aq më të mëdha janë gjasat që provat, dëshmitë, dëshmitarët dhe burime të tjera të zhduken dhe kështu është më e vështirë për të sjellë autorët para drejtësisë. Shkurtimisht, ekziston frika se duke vonuar drejtësinë, gjykatat e krimeve të luftës po kontribuojnë në një kulturë të mosndëshkimit me pasoja serioze për kujtesën kolektive dhe trashëgimi për drejtësinë, paqen dhe pajtimin. Ekziston gjithashtu një pakënaqësi e përhapur me strategjinë

⁴⁶ Fokus Grupi 6, 07 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë.

⁴⁷ Intervistë D, 19 nëntor 2020, Mitrovica, Kosovë. ⁴⁸ Fokus Grupi 8, 17 gusht 2020, në tërë Kosovën ⁴⁹ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁵⁰ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁵¹ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën.

prokuroriale të gjykatave ndërkombëtare dhe hibride të cilat janë përqendruar kryesisht në gjykimin e drejtuesve të lartë politik dhe ushtarak dhe në injorimin e autorëve të niveleve më të ulëta. Veçanërisht, ka pak besim në punën e Gjykatës Speciale të Kosovës sepse ajo shihet si e njëanshme dhe e padrejtë, duke synuar vetëm shqiptarët e Kosovës ndërsa injoron shumë raste të tjera të pretenduara të krimeve të luftës të kryera nga forcat serbe.⁵² Disa nga pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë theksuar se strategjia e ardhshme prokuroriale duhet të përqendrohet në sjelljen para drejtësisë jo vetëm të të dyshuarve të lartë të ushtrisë dhe policisë, por edhe të atyre individëve dhe grupeve që kanë ekzekutuar drejtpërdrejt krime lufte kundër popullatës civile shqiptare dhe aktualisht janë të lirë dhe me banim në Serbi.⁵³ Siç deklaroi një pjesëmarrës:

"Unë mendoj se autorët e dyshuar, që ne e dimë me siguri se kanë kryer krime, duhet të vihen para drejtësisë, si mënyra e vetme për të lehtësuar dhimbjen e viktimave dhe familjeve të tyre".⁵⁴

Pjesëmarrës të tjerë shqiptarë të Kosovës kanë theksuar se mos gjykimi i oficerëve lokalë të policisë dhe ushtrisë serbe të cilët ishin autorët e dyshuar të krimeve të luftës që dihen nga të mbijetuarit po ndikon drejtpërdrejt në mosgatishmërinë e komuniteteve shqiptare për të pranuar kthimin e refugjatëve serbë në vendbanimet e tyre para-konfliktit. Bashkëjetesa dhe pajtimi shihen si joreale pa drejtësi dhe mbyllje për krimet e së kaluarës. Për këtë arsye, familjet e personave të zhdukur shqiptarë të Kosovës kanë ngritur nevojën për krijimin e një Gjykate Speciale në Serbi (e ngjashme me Gjykatën e Specializuar për Kosovën) e cila do të merrej ekskluzivisht me krimet e luftës të kryera nga forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe në Kosovë.⁵⁵

Midis pjesëmarrësve serbë të Kosovës, një perceptim i shprehur gjerësisht është se do të jetë e vështirë për të sjellë autorët e krimeve para drejtësisë. Si gjykatat ndërkombëtare ashtu edhe ato kombëtare shihen si joefikase dhe të komprometuara. Ndërsa gjykatat ndërkombëtare kritikohen për mungesën e besueshmërisë dhe gjykimet e zgjatura, gjykatat kombëtare, veçanërisht ato në Kosovë, perceptohen si të mosbesueshme.⁵⁶ Disa nga pjesëmarrësit serbë shprehën hapur hezitimin ndaj drejtësisë gjyqësore për viktimat e krimeve të ndryshme pas vitit 1999 dhe shprehën mosbesim në gjyqësorin e Kosovës, kryesisht për shkak të perceptimit se gjyqet e krimeve të luftës kundër serbëve ishin të rremë dhe të trilluar.⁵⁷ Siç deklaroi një qytetar serb i Kosovës: "ne nuk besojmë më në drejtësinë tranzicionale si drejtësi".⁵⁸ Qëllimi i gjykatave ndërkombëtare ishte "vetëm për të gjykuar serbët dhe askënd tjetër".⁵⁹ Në mënyrë të ngjashme, nuk ka shumë pritje që Gjykata e Specializuar e Kosovës të japë drejtësi për viktimat.⁶⁰ Kjo është në përputhje me hulumtimet e mëparshme dhe sondazhet e opinioneve të kryera mbi pritjet dhe perceptimin e qytetarëve në këtë gjykatë.⁶¹ Perceptimi mbizotërues është se Kosova si një shoqëri thellësisht e polarizuar vuan nga mungesa e sundimit të ligjit, ku anëtarët e komuniteteve jo-shumicë nuk janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre plotësisht.⁶² Komunitetet më të vogla etnike kanë theksuar se gjykimet ndërkombëtare dhe kombëtare të krimeve të luftës nuk kanë sjellë drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarit e tyre. Ekziston një ndjenjë që mosndëshkimi për krime kundër bashkësive të vogla etnike normalizohet nga mosveprimi i institucioneve shtetërore dhe heshtja e grupeve të shoqërisë civile në Kosovë. Kështu, një pjesëmarrës rom shtoi se: "si pasojë e mosndëshkimit në të kaluarën, grupet më të vogla etnike kanë humbur besimin që gjyqësori mund të sjellë drejtësi".⁶³ Në mënyrë të ngjashme, një pjesëmarrës goran shtoi: "dështimi i gjyqësorit ka çuar në ndarje dhe urrejtje më të madhe midis komuniteteve".⁶⁴

⁵² Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁵³ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁵⁴ Fokus Grupi 4, 17 gusht 2020, rajoni i Pejës, Kosovë. ⁵⁵ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁵⁶ Fokus Grupi 8, 17 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁵⁷ Fokus Grupi 6, 07 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁵⁸ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁵⁹ Po aty. ⁶⁰ Fokus Grupi 6, 07 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁶¹ Visoka, Vlerësimi i ndikimit të mundshëm të gjykatës speciale të Kosovës; Ahmetaj dhe Unger, Korniza e Kosovës për Trajtimin e së Kaluarës në një pikë kthese. ⁶² Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁶³ Intervista B, 17.11.2020, Prishtinë, Kosovë. ⁶⁴ Intervistë D, 19 nëntor 2020, Mitrovica, Kosovë.

4.3 Reparacionet dhe mbështetja për viktimat dhe të mbijetuarit

Çështjet e dëmshpërblimeve të luftës dhe kompensimit për komunitetet e prekura, si dhe mbështetja socio-ekonomike për të mbijetuarit e konfliktit u ngritën po ashtu nga pjesëmarrësit. Megjithatë, ngjashëm me aspektet e tjera të drejtësisë tranzicionale, ka mendime të ndryshme, veçanërisht midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve mbi atë se kush duhet të paguajë dëmshpërblime dhe kush duhet të përfitojë nga skema të tilla. Që nga përfundimi i konfliktit, institucionet e Kosovës kanë ofruar ndihmë socio-ekonomike kryesisht për grupet e shqiptarëve të Kosovës si një formë e njohjes së vuajtjeve të tyre gjatë konfliktit. Ndërsa ndihma mbizotëruese u shkon veteranëve të luftës së UÇK-së (38,218), ka 8,713 përfitues midis familjeve të viktimave civile dhe personave të zhdukur, përfshirë 88 nga komuniteti serb.⁶⁵ Deri më tani, qeveria serbe ka refuzuar të trajtojë çështjen e dëmshpërblimeve të luftës dhe kompensimeve për dëmet e kohës së luftës. Kompensimi për dëmet në kohë lufte për viktimat e konfliktit në Kosovë të paraqitura në gjykatat serbe është dhënë vetëm për një numër shumë të kufizuar të çështjeve.⁶⁶ Në vend të kësaj, fokusi i qeverisë serbe ka qenë në kërkimin e aksesit dhe pretendimin e pronësisë së pronave shoqërore dhe kompanive në Kosovë, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së të kthyerve serbë.

Shqiptarët e Kosovës kanë theksuar se derisa të mos bëhen dëmshpërblimet për dëmet në kohë lufte – veçanërisht nga shteti serb – nuk ka gjasa të ketë paqe, mbyllje dhe gatishmëri për të vazhduar më tej.⁶⁷ Një mendim i ngjashëm ndahet nga komuniteti ashkali gjithashtu.⁶⁸ Megjithatë, deri më tani, vlerësimi i saktë i dëmeve të kohës së luftës mbetet një nga aspektet më të neglizhuara për trajtimin e së kaluarës në Kosovë. Ekziston një konsensus i gjerë që një strategji e ardhshme për drejtësinë tranzicionale duhet të ketë prioritet kthimin e kontributeve pensionale të shqiptarëve të Kosovës që janë mbajtur peng për më shumë se dy dekada nga autoritetet serbe. Kjo shihet si thelbësore për të adresuar shumë padrejtësi socio-ekonomike që po ndikojnë në mirëqenien e të moshuarve në Kosovë.⁶⁹ Disa nga pjesëmarrësit shqiptarë kanë sjellë rëndësinë e përdorimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si një rrugë e mundshme për kërkimin e kompensimit për krimet e luftës dhe dëmet e tjera të ndodhura gjatë konfliktit në Kosovë.⁷⁰ Për serbët e Kosovës, ofrimi i dëmshpërblimeve për dëmet e luftës për viktimat nuk shihet si një mënyrë për të zgjidhur problemet, përkundrazi ato shihen si një strategji për pranimin e gabimeve për keqbërje në të kaluarën dhe pendim.⁷¹ Për më tepër, pjesëmarrësit serbë të Kosovës besojnë se Serbia nuk duhet të paguajë dëmshpërblim për dëmet e kohës së luftës sepse ishte një konflikt i brendshëm dhe dëmshpërblimet janë të zbatueshme vetëm për konfliktet ndër-shtetërore dhe midis dy shteteve të njohura ndërkombëtarisht. Të tjerët kanë argumentuar se nëse Serbisë i kërkohet të paguajë dëmshpërblime për dëmet në Kosovë, atëherë edhe NATO duhet të paguajë për dëmet e shkaktuara në Serbi dhe për viktimat civile.⁷²

Midis shqiptarëve të Kosovës, personat e zhdukur dhe të afërmit e tyre, të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe veteranët e luftës u renditën si grupe kryesisht të prekura nga lufta në Kosovë, ndërsa nevoja për trajtim të ardhshëm psikologjik (çrregullim post-traumatik) dhe mbështetje ekonomike për ato viktimat dhe të mbijetuarat u konsideruan vendimtare në trajtimin e së kaluarës. Ekziston një farë njohje e punës pozitive të bërë nga institucionet e Kosovës, por prapëseprapë mbizotërimi i kufizimeve sociale dhe institucionale në njohjen dhe mbështetjen e këtyre viktimave shihet si një pengesë kryesore për ofrimin e një mase të drejtësisë dhe mbështetjes për këto komunitete të

⁶⁵ Të dhënat nga qershori 2020 tregojnë se ekzistojnë 785 shqiptarë viktimat e dhunës seksuale që marrin pension mujor nga Qeveria e Kosovës. ⁶⁶ Shih: HLC, Gjykimi i parë mbi përgjegjësinë e shtetit për krimet në Kosovë: Kompensimi për familjet e viktimave të kimit në Podujevo, 2016, Beograd. Në dispozicion në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=31649&lang=de> ⁶⁷ Fokus Grupi 1, 11 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁶⁸ Intervista A, 16 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ⁶⁹ Po aty. ⁷⁰ Fokus Grupi 5, 20 gusht 2020, rajoni i Mitrovicës, Kosovë. ⁷¹ Fokus Grupi 8, 17 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁷² Fokus Grupi 10, 02 shtator 2020, në tërë Kosovën.

prekura.⁷³ Përveç dëmshpërblimeve, pjesëmarrësit nga të gjitha grupet etnike kanë argumentuar se sigurimi i mundësive të punësimit për viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit është thelbësor për t'u dhënë atyre drejtësi socio-ekonomike, e cila është po aq e rëndësishme sa njohja e së vërtetës për të kaluarën ose sjellja e kryesve të veprës para drejtësisë. Në veçanti, pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë theksuar që komuniteteve të prekura duhet t'u jepen të drejta dhe privilegje të zgjeruara për të hyrë në arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime të tjera publike.⁷⁴ Rëndësia e krijimit të qendrave rehabilituese dhe psiko-sociale për ata që ende përjetojnë trauma lufte u soll rregullisht nga shqiptarët e Kosovës.⁷⁵ Iniciativat për të luftuar stigmën, për të ofruar psikoterapië (përfshirë terapië për familjet e viktimave dhe të mbijetuarve), lirim të viktimave dhe të mbijetuarve nga pagesa në zona të tilla si shëndetësia dhe arsimit u renditën si forma shtesë për të mbështetur viktimat dhe të mbijetuarit e luftës. Megjithatë, grupet etnike jo-dominuese kanë sjellë në pah pengesat institucionale dhe burokratike të cilat kanë parandaluar dhe ende vazhdojnë të parandalojnë, për shembull gratë rome viktimat dhe të mbijetuara që kërkojnë ndihmë dhe njohje.⁷⁶

Kështu, të gjitha grupet etnike në Kosovë kanë theksuar se një strategji e ardhshme nuk duhet të adresojë vetëm nevojën dhe shqetësimet e komuniteteve të prekura, por gjithashtu të parashikojë ndihmë dhe ndërtimin e kapaciteteve për ata që ndihmojnë, jetojnë me dhe mbështesin komunitetet e prekura direkt ose indirekt.⁷⁷ Në veçanti, midis të rinjve ekziston një perceptim se ata janë viktimat indirekte të konfliktit pasi janë rritur në një mjedis pas konfliktit dhe janë rritur me histori që i mishërojnë me përvojat e familjeve të tyre dhe të dashurve të tyre që janë prekur direkt nga konflikti. Ata e shohin veten si viktimat të gjeneratës së dytë të luftës dhe si të tillë kanë të drejtë të përfshihen në debate dhe të luajnë një rol në trajtimin e së kaluarës. Të rinjtë në të dy komunitetet janë më mendjehapur për t'u përfshirë në dialog ndëretnik dhe theksuan nevojën për pajtim për hir të një të ardhme më premtuese. Megjithatë, brezat e rinj në të dy komunitetet kanë njohuri të kufizuara të fakteve në lidhje me konfliktin. Qëndrimet e tyre ndikohen kryesisht nga narrativa dhe përvoja e familjeve dhe komuniteteve të tyre, si dhe nga diskursi më i gjerë publik dhe etnik.⁷⁸

4.4 Garancitë e mospërsëritjes

Si pjesë e proceseve të drejtësisë tranzicionale, garancitë institucionale dhe politike të mospërsëritjes të krimeve të luftës në të kaluarën dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut luajnë një rol jetik në rindërtimin e besimit dhe rivendosjen e marrëdhënieve midis grupeve në konflikt. Pa pasë pajtim për një zgjidhje paqësore, masat për të garantuar mospërsëritjen e krimeve të së kaluarës në Kosovë kanë ndodhur përmes rregullimeve institucionale dhe politike të imponuara nga ndërkombëtarët. Mungesa e zgjidhjes politike midis Kosovës dhe Serbisë dhe mungesa e një procesi të pajtimit politik manifestohet drejtpërdrejt në perspektivat e qytetarëve mbi vullnetin dhe aftësinë e autoriteteve shtetërore në të dy anët e kufirit për të sjellë drejtësi për viktimat dhe për të ndërtuar paqen në të ardhmen. Midis pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës ekziston një perceptim i gjerë që Serbia së pari duhet ta njohë Kosovën si një shtet sovran dhe të pavarur dhe pastaj të punojë së bashku në adresimin e trashëgimisë të së kaluarës.⁷⁹ Pa një njohje të tillë të ndërsjellë, çdo përpjekje për të zgjidhur çështje të tjera të pazgjidhura rrezikon të mos ketë sukses. Si pjesë e masave për të sjellë drejtësi në abuzimet e kaluara të të drejtave të njeriut, çështja e faljes zyrtare shtrohet si një çështje që duhet të kërkohet në strategjinë e ardhshme. Për pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës, falja zyrtare shihet si thelbësore për shkëputjen e institucioneve të tanishme

⁷³ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁷⁴ Fokus Grupi 2, 12 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁷⁵ Fokus Grupi 1, 11 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë.

⁷⁶ Intervista B, 17 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ⁷⁷ Fokus Grupi 1, 11 gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁷⁸ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁷⁹ Fokus Grupi 3, 13 gusht 2020, në tërë Kosovën.

shtetërore nga krimet e luftës në të kaluarën dhe ndërmarrjen e angazhimeve për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe për të hequr nga zyra publike individët e implikuar në krimet e luftës në të kaluarën. Sidoqoftë, për ta, garancitë e mospërsëristjes së padrejtësisë nga e kaluara shihen si jo-ekzistente për sa kohë që në Serbi elita qeverisëse ka trashëgimi të drejtpërdrejtë me regjimin e Millosheviqit, miraton dhe rehabiliton në mënyrë aktive kriminelët e luftës në jetën publike dhe promovon një diskurs luftarak ndaj Kosovës. Në veçanti, rrëfimi nationalist dhe antishqiptar i promovuar nga Qeveria Serbe dhe ministrat e tyre shihen si shembuj të qartë se Serbia nuk është e gatshme të merret me të kaluarën dhe nuk ofron asnjë garanci se krimet dhe padrejtësitë e së kaluarës nuk do të përsëriten më.⁸⁰ Në mënyrë të ngjashme, për serbët e Kosovës dominimi i pamjeve politike të Kosovës me ish-udhëheqjen ushtarake dhe politike të UÇK-së shihet si një bllokim i paqes etnike dhe pajtimit.⁸¹

Kështu, në mesin e komunitetit serb ekziston një ngurrim për t'u angazhuar me të kaluarën (veçanërisht ngjarjet e para-vitit 1999 dhe kohën e luftës) dhe në vend të kësaj fokusi i shqetësimeve ishte në situatën aktuale në Kosovë, ku perceptimi mbizotërues është se "shqiptarët e Kosovës nuk i njohin problemet e komuniteteve jo-shumicë, se ata nuk mund të solidarizohen me tema me rëndësi të përgjithshme, të tilla si e drejta për të përdorur gjuhën, dhe se ata injorojnë nevojat e komuniteteve të tjera, veçanërisht të serbëve".⁸² Pjesëmarrësit serbë kanë theksuar pakënaqësinë që ata ndihen të refuzuar nga komuniteti shqiptar i Kosovës ndërsa njëkohësisht kanë refuzuar të njohin përvojat dhe perspektivat e shqiptarëve në lidhje me padrejtësinë e kaluar.⁸³ Në veçanti, ekziston një perceptim midis serbëve që Qeveria e Kosovës duhet të bëjë më shumë për të adresuar nevojat e komunitetit serb ndërsa në të njëjtën kohë ekziston një tendencë për të refuzuar njohjen e Qeverisë së Kosovës si autoritetin legjitim në vend.⁸⁴ Sidoqoftë, ata deklarojnë se pikëpamja divergjente mbi statusin e Kosovës është "elementi kryesor që pengon udhëheqësit politikë të shqiptarëve të Kosovës të trajtojnë problemet e komunitetit serb më plotësisht dhe me cilësi më të mirë".⁸⁵ Megjithatë, midis serbëve ka gjithashtu pakënaqësi për kontrollin e Beogradit mbi fatin e tyre politik në Kosovë, duke theksuar tensionet dhe dinamikat ndër-etnike që luajnë një rol kryesor në parandalimin e pajtimit dhe tregimit të së vërtetës.⁸⁶ Për shembull, në lidhje me qëndrueshmërinë e një strategjie të ardhshme për drejtësinë tranzicionale, një pjesëmarrës serb i Kosovës theksoi frikën se "Beogradi do të vinte përsëri dorën e tij mbi serbët dhe do të thoshte - nuk mund të bësh siç e shkruan shqiptarët . [Pra]... Unë nuk jam optimist për ndonjë strategji".⁸⁷

Për bashkësitë e tjera më të vogla etnike në Kosovë, garancitë e mospërsëristjes kanë kuptime të ndryshme por ekziston një konsensus i gjërë që përpjekjet duhet të përqendrohen në përmirësimin e qeverisjes dhe promovimin e paqes, drejtësisë, barazisë dhe respektit në nivelin shtetëror dhe shoqëror. Një pjesëmarrës ashkali deklaroi "ne duhet të punojmë me fëmijë që në moshë të vogël, por edhe me prindërit e tyre".⁸⁸ Një pikëpamje e ngjashme vjen nga një pjesëmarrës goran, i cili e konsideron integrimin shoqëror dhe gjuhësor thelbësore për bashkëjetesën paqësore midis komuniteteve.⁸⁹ Një pjesëmarrës rom shtoi se përfshirja e të gjitha komuniteteve të prekura në proceset e drejtësisë tranzicionale është një qasje thelbësore për të siguruar që e kaluara të mos harrohet dhe të ndërtohet një e ardhme tjetër.⁹⁰ Për ta, përhapja e nacionalizmit në mesin e komuniteteve dominuese në Kosovë paraqet një kërcënim për komunitetin e tyre.⁹¹ Një pjesëmarrës turk i Kosovës megjithatë kishte një këndvështrim tjetër, duke deklaruar se "nëse duam të ndërtojmë paqe të qëndrueshme është e rëndësishme t'i forcojmë kapacitetet lokale dhe institucionet në të gjitha nivelet në mënyrë që t'i adresojmë shkaqet themelore të paqëndrueshmërisë. Ne duhet ta lëmë mënjatë të kaluarën tonë dhe të përqendrohemi në të ardhmen të gjithë së bashku".⁹²

⁸⁰ Fokus Grupi 2, 12 Gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁸¹ Fokus Grupi 8, 17 Gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁸² Konkluzione nga Fokus Grupi 6, 07 Gusht 2020, rajoni i Prishtinës, Kosovë. ⁸³ Fokus Grupi 5, 20 Gusht 2020, rajoni i Mitrovicës, Kosovë. ⁸⁴ Po aty. ⁸⁵ Po aty. ⁸⁶ Fokus Grupi 8, 17 gusht 2020, në tërë Kosovën. ⁸⁷ Fokus Grupi 9, 01 shtator 2020, Mitrovica e Veriut, Kosovë. ⁸⁸ Intervista A, 16 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ⁸⁹ Intervistë D, 19 nëntor 2020, Mitrovica, Kosovë. ⁹⁰ Intervista B, 17 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë. ⁹¹ Intervistë E, 23 nëntor 2020, Graçanicë, Kosovë. ⁹² Intervistë C. 18 nëntor 2020, Prishtinë, Kosovë.

INFRASTRUKTURA PËR TRAJTIMIN E SË KALUARËS NË KOSOVË (IPTEK)⁹³	
1. Vizioni strategjik dhe të kuptuarit kombëtar i TeK	Shqyrtimet
Bërthama: Parimet ⁹⁴ dhe etika për DT/TeK në Kosovë, që promovon tri elemente:	<i>*të sigurohet angazhim i gjërë popullor e politik + pronësi për legjitimitet dhe konsensus mes gjitha segmenteve shoqërore</i>
1) Randësia e qasjeve të përqëndruara tek viktimat dhe të mbijetuarit	
2) Barazi dhe ndjeshmëri më e madhe gjinore	
3) De-etnizimi, depolitizimi, dhe depersonalizimi i nismave të DT/TeK	
Të zhvillohet përmes proceseve të gjëra të konsultimit dhe përfshirjen e të gjitha segmenteve shoqërore	
2. Mbajtje kolektive e dijenisë dhe të dhënave për DT/TeK në Kosovë	Shqyrtimet
Bërthama: njohuri e centralizuar, interaktive, dhe e qasshme për drejtësinë tranzicionale në Kosovë, me këto funksione:	<i>*i afrohet gjithë qytetarëve dhe komuniteteve të prekura në të gjitha gjuhët e Kosovës *menaxhohet nga një autoritet adekuat dhe politikisht i pavarur</i>
- Dokumentimi i punës së mekanizmave dhe iniciativave ekzistuese, përfshirë: ligjet, raportet dhe të dhëna të institucioneve shtetërore, çështje gjyqësore, studime nga grupe studimore, OJQ dhe komuniteti akademik, histori gojore, histori nga qytetarë dhe përmajtje tjetër që kap përvojat e të gjitha grupeve etnike në Kosovë	
- Informimi i hartimit të politikave nga të dhëna dhe njohuri të disponueshme për publikun	
Publikisht i arritshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë qytetarët për të marrë informacion mbi të gjitha çështjet e Drejtësisë Tranzicionale	
- Të menaxhohet nga një autoritet adekuat dhe politikisht i pavarur	
3. Strategji Kombëtare nga poshtë-lart dhe e përqëndruar tek viktimat për DT/TeK	Shqyrtimet
Bërthama: Vizioni strategjik dhe korniza gjithëpërfshirëse për koordinimin, harmonizimin dhe shikimin afatgjatë për institucionet dhe organizatat joqeveritare.	<i>*kërkon pjesëmarrje transformuese të komuniteteve të prekura përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë në të gjitha fazat e procesit</i>
E rëndësishme është që kjo të projektohet si diskutim; kjo do të thotë që nevojat dhe interesat e të gjithë qytetarëve të prekura (përfshirë viktimat, të mbijetuarit, veteranët, gratë, të rinjtë) vendosen në qendër të vendimmarrjes përpara se të hartohen politikat dhe mekanizmat. Në këtë mënyrë, iniciativat specifike të përshtatshme për kulturën dhe kontekstin mund të zhvillohen.	
Nevoja që të udhëhiqet nga vendi: të mos 'zaptohen' nga 'modele të jashtme.	
4. Infrastruktura Institucionale për TeK	Shqyrtimet
Bërthama: Infrastruktura ombrellë për koordinimin e iniciativave dhe burimeve institucionale dhe joqeveritare që promovojnë TJ. Funksione:	<i>*menaxhimi nga një autoritet adekuat dhe i pavarur politikisht *transparente *e hapur për publikun</i>
- Shkëmbim informacioni dhe takime të rregullta konsultative; - Mbështetja e zgjidhjes së problemeve interaktive, bashkëpunuese dhe diskutuese për çështje specifike të Drejtësisë Tranzicionale; - Sigurimi i një hapësire për komunitetet e prekura për të kanalizuar nevojat e tyre, për të lobuar për të drejtat dhe interesat e tyre; - Ofrimi i shërbimeve këshilluese dhe konsultime për komunitetet e prekura dhe palët e interesuara përkatëse; - Monitoron pajtueshmërinë me parimet e Drejtësisë së Tranzicionale dhe zbatimin e strategjisë kombëtare për DT nga palë të ndryshme të interesit; - Të shërbejë si një platformë për prodhimin, dokumentimin dhe ndarjen e njohurive për DT; - Lidhë proceset e DT me ndërtimin e paqes dhe aktivitetet e zhvillimit për të promovuar paqen, drejtësinë dhe një të ardhme të përbashkët.	

⁹³Përmbledhje grafike e raportit 'Demokratizimi Drejtësisë Tranzicionale, Drejt një Infrastrukture Diskutuese për Trajtimin e së Kaluarës në Kosovë', maj 2020, nga autorët e njëjtë. ⁹⁴Ekziston një iniciativë e vazhdueshme nga shoqëria civile e Kosovës që synon të zhvillojë parime "që do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike" dhe synon "të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit": 'Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën për kontekstin e Kosovës', drafti i dokumentit të brendshëm, nëntor 2020.

ELEMENTET KRYESORE TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR TEK/DT NË KOSOVË

[Shënim: kjo përmbledhje bazohet në gjetjet në këtë studim; një konsultë më gjithëpërfshirëse mund të gjejë nevoja shtesë midis komuniteteve të prekura]

Shtylla	Problemet	Çka
Kërkimi i të vërtetës	<ul style="list-style-type: none"> - e vërteta shihet ndryshe nga secili grup etnik; të gjithë kanë dispozita që të kërkojnë të vërteta, përkujtime dhe dokumentime mono-etnike të së kaluarës; - Mungesë e madhe e të dhënave të besueshme për krimet dhe abuzimet serioze me të drejtat e njeriut; - Anashkalim dhe përjashtim i nevojave të pakicave tjera; - Shumë pak ndjeshmëri dhe të kuptuar të perspektivave të njëri tjetrit dhe përvojave të konfliktit. 	<ul style="list-style-type: none"> - E vërteta dhe dokumentacioni në lidhje me krimet e para luftës dhe të kohës së luftës dhe abuzime të tjera të rënda të të drejtave të njeriut; - E vërteta dhe dokumentacioni për pas-luftën dhe krimet e rënda të fundit; - E vërteta për personat e zhdukur; - Zbërthimi i narrativave dominuese (të njëanshme / etno-kombëtare) dhe edukimi mbi të dhënat faktike të konfliktit përmes narrativave, arkivave, muzeve për luftën dhe librave shkollorë të historisë.
Gjykimet e krimeve të luftës	<ul style="list-style-type: none"> - Kryesisht shihet si i rëndësishëm për TeK por ka perceptim të përgjithshëm negativ për gjykatat dhe gjykimet e krimeve të luftës; - Perceptimi që 'grupi etnik i tyre' është shënjestruar në mënyrë selektive; - Pakënaqësia që vetëm individë të rangut të lartë ndiqen penalisht ndërsa shumë autorë të dyshuar mbeten të lirë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtësia për krimet e para luftës dhe të kohës së luftës; - Drejtësia për krimet e rënda të pasluftës dhe ato të fundit
Reparacionet / kompensimi dhe mbështetja	<ul style="list-style-type: none"> - Shumë padrejtësi socio-ekonomike në lidhje me kohën e luftës nuk janë adresuar; p.sh. : kontributet e pensioneve në sistemin serb nuk u kthehen shqiptarëve të moshuar; - Mungesë ose kompensim/mbështetje e kufizuar nga Qeveria e Kosovës për komunitetet e prekura - përveç veteranëve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Nevoja për reparacione dhe kompensim nga Serbia për dëmet e luftës; - Përkrahje psikosociale, rehabilituese dhe financiare për të gjitha komunitetet e prekura (përfshirë për të mbijetuarit e dhunës seksuale); - Asistencë dhe ndërtim i kapaciteteve për ata që ndihmojnë, jetojnë dhe përkrahin komunitetet + gjeneratën e dytë (rininë) e komuniteteve të prekura direkt apo indirekt
Garancitë e mospërsëritjes	<ul style="list-style-type: none"> -Mungesa e marrëveshjes së paqes midis Serbisë dhe Kosovës dhe mosnjohja e Kosovës nga ana e Serbisë është pengesë e madhe për komunitetet dominuese në Kosovë për të jetuar të qetë; - Skenat politike në Serbi dhe Kosovë të dominuara nga luftëtarë / politikanë të kohës së luftës; duke vazhduar dominimin e rrëfimeve të njëanshme etno-nacionaliste. 	<ul style="list-style-type: none"> -Kërkim falje zyrtare nga Serbia (dominimi dhe rehabilitimi i politikanëve të regjimit të Millosheviqit në Serbi të dëmshëm për paqen dhe drejtësinë); - Dominimi i politikanëve të lidhur me UÇK-në në Kosovë të dëmshëm për paqen dhe drejtësinë; - Përmirësimi i qeverisjes dhe promovimi i paqes, drejtësisë, barazisë dhe respektit në nivelin shtetëror dhe shoqëror; - Mbrojtja e të drejtave të pakicave.

5. Përfundimet dhe rekomandimet

Ky studim ofroi një përmbledhje të perspektivave të qytetarëve mbi atë se cilat duhet të jenë parimet udhëzuese dhe fokusi tematik i një strategjie të ardhshme për drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Duke u mbështetur në vëzhgimet nga të gjitha diskutimet në fokus grupe dhe bisedat individuale, kjo pjesë përfundimtare ofron pesë rekomandime të cilat mund të jenë të dobishme për të gjithë ata që janë të përfshirë në hartimin e një strategjie të ardhshme. Në përgjithësi, qytetarët e Kosovës presin që Qeveria e Kosovës duhet të marrë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar kah viktimat dhe të mbijetuarit kur harton një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale në të ardhmen. Një qasje gjithëpërfshirëse në të ardhmen ka më shumë të ngjarë të ketë sukses nëse gëzon legjitimitet procedural mes komuniteteve përfituese, përkatësisht kur ajo është hartuar përmes një procesi pjesëmarrës që ka në qendër qytetarët, i cili siguron pronësinë lokale dhe përfshirjen në të gjithë procesin e drejtësisë tranzicionale. Shoqatat e viktimave duhet të përfshihen për të siguruar pjesëmarrje më të gjerë në këtë proces, por gjithashtu duhet të ketë përfshirje të drejtpërdrejtë të viktimave dhe anëtarëve të familjeve të tyre të cilët kanë më pak mundësi për t'i shprehur nevojat e tyre. Në mënyrë të ngjashme, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë mund të fillojnë një fushatë për të promovuar një qasje të tillë dhe nga themelimi të ndërtojnë konsensus politik dhe multi-etnik mbi parimet, qëllimin, fushën dhe funksionet e strategjisë së ardhshme për drejtësinë tranzicionale.

Rekomandimi 1: *Një strategji e ardhshme për drejtësinë tranzicionale duhet të zhvillohet përmes një procesi nga poshtë-lart, ku të gjitha komunitetet e prekura këshillohen ngushtë dhe përfshihen në përcaktimin e nevojave të tyre, në ofrimin e hapësirës dhe mbështetjes për të kontribuar në hartimin e modaliteteve institucionale dhe praktike në përmbushjen e nevojave të tyre dhe konsultohen nga afër dhe rregullisht gjatë fazës së zbatimit dhe vlerësimit.*

Qytetarët kanë theksuar se një strategji e ardhshme duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse, e cila bashkon dhe integron shtylla të ndryshme të drejtësisë tranzicionale për të siguruar që nevojat e komuniteteve të prekura adresohen në një mënyrë holistike dhe gjithëpërfshirëse. Derisa gjithëpërfshirja dhe inkluzioni janë thelbësor për të siguruar që një strategji përfundimtare adreson nevojat e të gjitha komuniteteve të prekura dhe kështu gëzon legjitimitet të gjerë lokal, përhapja e perceptimeve të bazuara në identitet për konfliktin dhe trashëgiminë e tij mund të jetë një pengesë kryesore në vetvete për të ecur përpara. Megjithatë, një sfidë e madhe mbetet se si të sigurojmë që e vërteta, drejtësia dhe pajtimi të promovohen njëkohësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse duke marrë parasysh pikëpamjet dhe pozicionet e ndryshme të komuniteteve etnike. Në veçanti, gjithëpërfshirja nuk duhet të gabohet me barazimin e fajit ose përgjegjësisë për keqbërjet e së kaluarës. Përkundrazi, strategjia e ardhshme duhet të shërbejë si një platformë ku shumë anë të të vërtetës duhet dalë në shesh, që drejtësia t'u silltet viktimave në një bazë jo-selektive dhe jo-etnike dhe që të drejtat të shpërndahen në një të proces të drejtë, të barabartë dhe gjithëpërfshirës.

Rekomandimi 2: *Një strategji e ardhshme duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse, duke mbledhur së bashku dhe duke integruar shtylla të ndryshme të drejtësisë tranzicionale në mënyrë që nevojat e komuniteteve të prekura të adresohen në një mënyrë holistike dhe gjithëpërfshirëse.*

Mes të gjithë pjesëmarrësve ekziston ngurrimi që pavarësisht se sa mirë është shkruar një strategji e ardhshme për drejtësinë tranzicionale, ajo mund të dështojë të zbatohet në praktikë.⁹⁵ Kjo buron nga një besim i kufizuar në organet qeveritare në përgjithësi dhe në veçanti në zbatimin e ligjeve dhe politikave. Për të adresuar këtë shqetësim, ekziston një nevojë për një mekanizëm institucional i cili bashkon strategjitë ekzistuese ndërkombëtare dhe kombëtare të ndjekjes së krimeve të luftës, ligjet dhe mekanizmat për personat e zhdukur, ndihmën sociale për komunitete të ndryshme të prekura dhe kërkimin, dokumentimin dhe përkujtimin. Për më tepër, gjatat që një strategji e ardhshme të ketë sukses varet nga një konsensus i gjithë vendit për rëndësinë e vendosjes së përparësive për hartimin e politikave dhe zbatimin e drejtësisë tranzicionale, që përfshin vullnet politik midis të gjitha partive politike, grupeve etnike, grupeve të shoqërisë civile dhe shoqatave që përfaqësojnë të prekurit nga komunitetet, si dhe misionet ndërkombëtare dhe donatorët në Kosovë.

Rekomandimi 3: *Një strategji e ardhshme duhet të parashikojë një infrastrukturë institucionale për trajtimin e së kaluarës në Kosovë, e cila do të koordinojë, monitorojë dhe mbështesë ligjet, strategjinë, politikat dhe mekanizmat ekzistuese dhe të ardhshme specifike të sektorit mbi shtyllat e ndryshme të drejtësisë tranzicionale që merren me të kaluarën.*

Njohuritë e përgjithshme midis pjesëmarrësve në lidhje me punën e gjykatave ndërkombëtare, hibride dhe kombëtare të krimeve të luftës duket të jenë të kufizuara. Njohuritë e publikut për krimet e luftës dominohen nga media dhe televizionet, nga interneti si dhe nga një numër i madh protagonistësh dhe vendimmarrësish. Ekziston nevoja për ta zhvendosur diskursin publik nga zhargoni spekulativ dhe i ngarkuar në raportime më të bazuara në prova, të sakta dhe të ekuilibruara për drejtësinë tranzicionale. Institucionet shtetërore dhe organet gjyqësore duhet të punojnë ngushtë me komunitetin e shoqërisë civile dhe mediat për të promovuar raportim të saktë dhe të bazuar në fakte mbi gjyqet e krimeve të luftës për të trajtuar kornizat nënçmuese dhe negative të proceseve të drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Në veçanti, ekziston një nevojë e ngutshme për të hartuar programe edukative dhe informuese që rrisin njohuritë e publikut të gjerë mbi drejtësinë tranzicionale. Seminaret e shoqërisë civile, punëtoritë dhe leksionet e pjesëmarrësve nga komunitete të ndryshme duket se kanë pasur një ndikim pozitiv në të kaluarën, prandaj promovimi i një bashkëpunimi më të madh, veçanërisht midis të rinjve, mund të përfitonte kryesisht nga proceset tranzicionale të drejtësisë. Intervistat me histori gojore dhe mbledhja e tregimeve personale mund të kontribuojnë gjithashtu në dokumentimin e të kaluarës.

Rekomandimi 4: *Një strategji e ardhshme duhet të parashikojë programe edukative dhe informuese që mund të zbatohen së bashku me shkollat publike, mediat dhe grupet e shoqërisë civile për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e trajtimit të së kaluarës në Kosovë, adresimin e trashëgimisë së luftës dhe sjelljen e drejtësisë për viktimat.*

Krejt në fund, zgjidhja e çështjes së dëmshpërblimit të luftës dhe garancitë e mospërsëritjes në të ardhmen ka të ngjarë të varen nga një marrëveshje eventuale për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës. Edhe pse një strategji e ardhshme për drejtësinë tranzicionale ka të ngjarë të përjetojë shumë pengesa, ajo është rruga e vetme për të siguruar që e kaluara të mos shmanget dhe që një masë e drejtësisë t'u shërbehet të gjitha komuniteteve të prekura, që e vërteta të dal në shesh dhe që brezat e rinj të mos mbahen peng i së kaluarës, por të shkojnë drejt një shoqërie më të drejtë dhe më paqësore. Në pritje të një rezultati të tillë, ka arsye për autoritetet dhe grupet e shoqërisë civile në Kosovë me ndihmën e BE-së dhe donatorëve të tjerë që të punojnë së bashku në hartimin dhe mbledhjen e fakteve të dëshmuara të kostos së vërtetë njerëzore, materiale dhe socio-

⁹⁵ Fokus Grupi 5, 20 gusht 2020, rajoni i Mitrovicës, Kosovë.

ekonomike të konfliktit dhe dëmet e shkaktuara të gjitha grupeve etnike në Kosovë. Ekziston gjithashtu një nevojë e ngutshme për të verifikuar dhe arritur një marrëveshje të përbashkët mbi shifrat e shkaqeve të lidhura me konfliktin, viktimat dhe të tjerët të prekur nga konflikti. Në mënyrë të ngjashme, masat e ndërtimit të besimit dhe garancionet institucionale nga të dy palët janë thelbësore për të demonstruar pozitivisht angazhimin për ndërtimin e paqes, bashkëjetesës dhe për ecjen përpara.

Rekomandimi 5: *Dialogu i lehtësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të adresojë çështjet e ngutshme dhe të pazgjidhura për t'u marrë me të kaluarën ndërsa një marrëveshje eventuale duhet të marrë parasysh nevojat dhe perspektivat e të gjitha komuniteteve të prekura.*

Si përfundim, argumenti për një qasje gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale dhe trajtimin e së kaluarës është i fuqishëm dhe vetëm përmes një procesi nga poshtë-lart, me në qendër qytetarin dhe gjithëpërfshirës, një strategji dhe veprim i ardhshëm institucional ka të ngjarë të gëzojë legjitimitet të gjerë publik dhe të ketë ndikim në mbylljen e kapitujve të së kaluarës dhe hapjen e kapitujve të rinj me shpresë për një të ardhme më të mirë.

6. Anekset

6.1 Korniza Ligjore e Kosovës për Trajtim të së Kaluarës dhe Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë

Ligji Nr. 04 / L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe familjeve të tyre. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436>].

Ligji Nr. 04 / L-023 për Personat e Zhdukur. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2765>].

Ligji Nr. 06 / L-054 mbi Gjykatat. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>].

Ligji Nr. 03 / L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2526>].

Ligji nr. 05 / L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11036/>].

Ligji Nr. 04 / L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2758>].

Ligji Nr. 04 / L-31 për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështjet Penale. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2769>].

Kodi nr. 06 / L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>].

Ligji Nr. 06 / L-091 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Procedurës Penale. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20500>].

Ligji Nr. 05 / L-060 për Mjekësinë Ligjore. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12325>].

Ligji Nr. 03 / L-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Pastrimin e Sigurisë. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2690>].

Ligji jo 05 / L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>].

Ligji Nr. 03 / L-053 për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Alokimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2527>].

Ligji Nr. 03 / L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>].

Ligji Nr. 02 / L-37 për përdorimin e gjuhëve.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>].

Ligji Nr. 03 / L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>].

Ligji Nr. 03 / L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>].

Ligji Nr. 03 / L-95 për të Drejtat e Ish të Dënuarve Politikisht dhe të Përndjekurve.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2738>].

Ligji Nr. 06 / L-059 në Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18130>].

Ligji Nr. 06 / L-073 për Statusin e Punonjësve të Arsimit Shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti akademik 1990/91 deri në vitin akademik 1998/99.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18857>].

Ligji Nr. 04 / L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Kosovë.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8657>].

Ligji Nr. 04 / L-174 për Planifikimin Hapësinor.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8865>].

Ligji Nr. 05 / L-010 mbi Agjencinë e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave të Kosovës.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13023>].

Ligji Nr. 04 / L -261 mbi Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

[<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9435>].

6.2 Lista e diskutimeve në fokus grupe dhe intervistat.

Nr.	Kategoria	Numri i Pjesëmarrësve	Data	Vendndodhja	Metoda
Fokus Grupi 1	Gratë (Shqiptare të Kosovës)	14	11.08.2020.	Rajoni i Prishtinës	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 2	Rinia (komuniteti shqiptar)	14	12.08.2020.	Rajoni i Prishtinës	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 3	Famijarët e personave të pagjetur (komuniteti shqiptar)	13	13.08.2020.	Në tërë Kosovën	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 4	Grup i përzier (komuniteti shqiptar)	17	17.08.2020.	Peja region	Personalisht
Fokus Grupi 5	Grup i përzier (komuniteti shqiptar)	15	20.08.2020.	Rajoni i Mitrovicës	Personalisht
Fokus Grupi 6	Gratë (komuniteti serb)	15	07.08.2020.	Rajoni i Prishtinës	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 7	Grup i përzier (komuniteti serb)	15	12.08.2020.	Rajoni i Gjilanit	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 8	Rinia (komuniteti serb)	15	17.08.2020.	Në tërë Kosovën	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 9	Grup i përzier (komuniteti serb)	15	01.09.2020.	Mitrovicë e Veriut	Online (me Zoom)
Fokus Grupi 10	Grup i përzier (komuniteti serb)	15	02.09.2020.	Në tërë Kosovën	Online (me Zoom)

Kodi	Kategoria	Data	Vendndodhja	Metoda
Intervistë A	Aktivist i shoqërisë civile ashkali	16.11.2020.	Prishtinë	Online (me Zoom)
Intervistë B	Aktivist i shoqërisë civile rome	17.11.2020.	Gjakovë	Online (me Zoom)
Intervistë C	Aktivist i shoqërisë civile turke	18.11.2020.	Prizren	Telefon
Intervistë D	Aktivist i shoqërisë civile gorane	19.11.2020.	Mitrovica	Personalisht
Intervistë E	Aktivist i shoqërisë civile rome	23.11.2020.	Graçanica	Email
Intervistë F	Aktivist boshnjak i shoqërisë civile	24.11.2020.	Mitrovica	Personalisht

Dhjetor
2020

PAX inTegra



NEW SOCIAL RELATIVE

